



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 708/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.10.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit”, me nr. REF-55053-03-09-2018, me fond limit 139,642,150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

**Ankimues:** Operatori ekonomik “Rej” sh.p.k.  
*Adresa: L.3, Shëtitorja “Europa”, Pogradec.*

**Autoriteti kontraktor:** Bashkia Maliq  
*Adresa: Bulevardi “Rinia”, Maliq.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”;

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, i cili e ka refuzuar atë, dhe më pas ka paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”;

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës të operatorit ekonomik ankimues.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1 Në datën 12.03.2018, në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit, “Procedurë e Hapur”, me objekt, “Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit”, me nr. REF-55053-03-09-2018, me fond limit 139,642,150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

II.2 Në datën 17.07.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 02.08.2018, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave ku rezulton si më poshtë vijon:

1. "Rej" shpk,	119,234,123.00 lekë pa tvsh Skualifikuar;
2. "Pastrime Silvio" shpk,	125,682,435.25 lekë pa tvsh Skualifikuar;
3. "Korsel" shpk,	136,398,947.25 lekë pa tvsh Kualifikuar;
4. "Silver" shpk,	137,000,000.00 lekë pa tvsh Skualifikuar;

II.4.Nga verifikimet e kryera, rezulton se operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. është njoftuar nëpërmjet Sistemit e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e mësipërme të prokurimit, për arsyet si më poshtë vijon:

*"1 - Ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme të realizuara në tre vitet e fundit .- Operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. për të vërtetuar se ka kryer eksperiencë të mëparshme të ngjashme gjatë tre viteve të fundit, ka paraqitur dy kontrata, njëra me ish Komunen Udenisht dhe tjetra është lidhur me Bashkinë Pogradec ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k., në të cilën nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k., në mënyrë që të përlllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria "Rej" sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.- Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec date 16.01.2015 , ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi I shoqërive "Rej" sh.p.k. dhe "Shpresa" sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve, ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec Nr.4634/1 prot., date 26.06.2018 nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontratë është realizuar me sukses dhe I vetëm nga shoqëria "Rej" sh.p.k. ( në kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 të ndryshuar neni 74, pika 2 , Bashkimi I Operatoreve ekonomike , ) edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë "Rej" sh.p.k.*

*2 - Ka mangësi në përmbushjen e kriterit teknik 3.2.11 kapacitetet teknike për realizimin me sukses të kontratës. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

*Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme: - "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasi të përkatëse për mjetet e disponueshme. - Në rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve. - Kontratat dhe marrëveshjet e sipërcituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj. - Nuk ka deklarate me shkrim për disponimin e mjeteve ku të specifikohet lloji I mjetit, për se do përdoret , targa e tij , të dhënat teknike të mjeteve , me qira /në pronësi/apo lloji tjetër - Në kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirasë , nuk përcaktohet lloji I mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet*

3–Mungon leja mjedisore , kodi III.1.A sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).

a. Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh . (Kodi III.1.A). - Leja e paraqitur PN -2521-04-2016 është “Stacion transferimi për mbetje jot ë rezikshme” dhe leja tjetër PN -5796-09-2017 është “Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të amballazheve ,paketimeve ose kontinjerëve në mënyrë që të ripërdoren.

4 – Ka mangesi ne permbushjen e pikës 3.2 Kapacitetet teknike , pika5 : Operatori ekonomik te kete te punesuar Mjekun e shoqerise , e vertetuar kjo me - Kontratë pune (e vlefshme), - Urdhër Mjeku, - CV, - librezë pune, - diplomën përkatëse. -Te jete ne listepagesa per periudhen janar 2017- janar 2018. - Mjekja Ersjona Topalli nga verifikimi i listë pagesave figuron me lejë lindje për periudhën Gusht 2017- Janar 2018”

II.5.Në datën 08.08.2018 operatori ekonomik ankimues ”Rej” sh.p.k. ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.6. Nga verifikimet e kryera në dokumentacionin e paraqitur pranë KPP, me anë të shkresës Nr. 3052/1 Prot. datë 15.08.2018, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues ”Rej” sh.p.k., duke mos pranuar asnjë prej pretendimeve të ngritura prej tij, si dhe duke shtuar arsye skualifikimi, me argumentimin si më poshtë vijon: “[...]Lidhur me pretendimin e pare.

O.E “REJ” shpk ka paraqitur dy kontrata: 1 . Kontratë e lidhur ndermejt O.E “REJ” shpk dhe Komunën Udënisht, date 30.04.2012 per nje periudhe pese vjeçare me objekt “Per pastrimin dhe largimin e mbeturinave urbane nga komuna”, me ne çmim prej 3.487.980 leke me tvsh per nje vit sherbim. 2. Kontrate e lidhur ndermjet Bashkimit te Operatoreve Ekonomike (B.O.E)“REJ” SHPK dhe “Shpresa” shpk dhe Bashkise Pogradec ,date 16.01.205 per nje periudhe 5(pese) vjeçare me objekt: Pastrimi,grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike te qytetit te Pogradecit” me nje vlere totale prej 198.062.504 leke me tvsh. KSHA bazuar ne dst ,kerkesat kualifikuese si dhe ne kontratat e paraqitura nga OE “Rej” konstatoi se: Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga OE “ Rej” rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme. Ne Kontraten e lidhur mes Bashkise Pogradec dhe Bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k. dhe e firmosur dhe vulosur nga te dy OE ,nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k., në mënyrë që të përllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria ”Rej” sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec, ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i operatorëve ekonomik ”Rej” sh.p.k. dhe ”Shpresa” sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve dhe ndarja e shërbimeve dhe llojit te tyre sipas kësaj % , sipas

nenit 74/2 e VKM Nr. 914 , date 29.12.2014 e ndryshuar. Ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontratë është realizuar i vetëm nga shoqëria "Rej" sh.p.k. edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë (BOE) dhe jo vetëm me shoqërinë "Rej" sh.p.k. Gjithashtu, edhe vërtetimi Nr.4634/1 ,datë 26.06.2018, e Bashkisë Pogradec ka mangësi, pasi thekson se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes me datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit të qytetit Pogradec në bazë të nenit 74 , pika 5 , të Vendimit Nr. 914 , date 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar për periudhë 17 janar 2015 deri më 31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga OE " Rej " shpk dhe nuk jep asnjë shpjegim apo document pse është në kushtet e nenit 74/5 te VKM Nr. 914 si më poshtë: Ne rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të Operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjara që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator ekonomik tjetër, antar i bashkëpunimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Për ndryshe autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëhere detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të meren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një antar tjetër i bashkimit me kusht që ky të plotësojë kërkesat. Ne ankesën e tij Operatori "Rej" shpk nënvizon : Theksojmë se ka një dallim të qartë dhe esencial , logjik dhe ligjor mbi momentin e dorëzimit të ofertave në një procedure prokurimi në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të kontratës nga ana tjetër, mbi të gjitha kur zbatimi i kontratës në masën 100 % nga antari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë është pranuar nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe është deklaruar me akt që në momentin e dorëzimit të ofertave nga shoqëria jonë. Nga sa më sipër nuk ka asnjë document tjetër që të vërtetojë se Operatori tjetër " Shpresa" shpk është në falimentim referuar dhe nenit Nr 24 Nderprerja per shkak te Falimentimit, te kontrates te lidhur ne date 16.01.2015 ndermjet BOE "Shpresa" shpk dhe "Rej" shpk me Bashkine Pogradec, apo në rrethana të tjera për të cilat Bashkia Pogradec e vazhdon zbatimin e kontratës vetëm me operatorin " Rej " shpk apo ndonjë akt deklarimi të pranuar nga bashkia Pogradec që në momentin e dorëzimit të ofertave .Po të kishte një document të tillë ai duhet të ishte paraqitur ne SPE sepse bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Shtrojmë pyetjen -Si ka mundesi qe nga njera ane na paraqitet nje kontrate e lidhur me bashkim te O.E Rej shpk dhe Shpresa shpk dhe nga ana tjeter na paraqitet nje vertetim ku citohet se sherbimi eshte kryer i vetem nga OE Rej shpk. -Kur i plotësoi operatorin " REJ" shpk kërkesat e vendosura nga Bashkia Pogradec një ditë pasi ka lidhur kontratën me këtë të fundit ? Bashkia Pogradec në përgjigjen që i kthen KVO ka dështuar në dhënien e informacionit të kërkuar sepse duhet të kishte argumentuar dhe dokumentuar pse zbatimi i kontratës bëhet vetëm nga Operatori "REJ" shpk dhe jo një përgjigje të shkurtër se Sherbimi i pastrimit te qytetit te Pogradecit eshte kryer ne perputhje me kushtet e kontratës dhe detyrimet jane marre persiper vetem

nga shoqeria " REJ" shpk në zbatim të parashikimeve ligjore , kushteve dhe rethanave të përcaktuara nga neni 74 , pika 5 e VKM -së Nr 914 , datë 29.12.2017 , të ndryshuar . Lidhur me kontraten e realizuar me Komunën Udënisht, theksojme se OE nuk arrin të përmbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar, (sipas shkresës 349/1 datë 20.02.2018 të Bashkisë Pogradec zbatimi i kontratës për shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane nga Komuna Udënisht për periudhën 30 Prill 2012 deri në 30 Prill 2017 është realizuar nga OE "Rej" shpk vlera e realizuar për këtë shërbim është 11,549,734 lekë pa tvsh sipas situacioneve mujore. Kjo kontratë është realizuar me sukses nga OE " Rej " shpk . Pra vlera e realizuar në pesë vjet është 11,549,734 lekë kurse në tre vitet e undit 6,929,840 lekë. Konkluzion : sa më sipër, 1. Kontratat e paraqitura nuk mund të merren në konsideratë për shkak të mangësive dhe konkretisht: a. Tek kontrata e lidhur nga BOE REJ shpk dhe Shpresa shpk me Bashkinë Pogradec mungon përqindja e bashkepunimit që ka secili operator ekonomik në këtë bashkim operatorësh, me qëllim që të bëhet përlllogaritja e shërbimeve të kryera nga REJ shpk e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, dhe nuk ka asnjë dokument apo amendament që verteton se Bashkia Pogradec ka lidhur me OE "REJ" shpk për të realizuar e vetme zbatimin e kontratës. b. Tek kontrata e lidhur ndërmjet REJ shpk dhe Komunes Udenisht ,vlera e kontratës së realizuar është poshtë vlerës së kërkuar në dokumentat e tenderit 2. Kontratat e paraqitura nga OE "REJ" shpk me objekt pastrimin dhe largimin e mbeturinave urbane nuk përmbushin kërkesat e pikës 3.2 pika 1.a për shërbime të ngjashme në të gjithë elementet e objektit që tenderohet "Shërbime të pastrimit dhe gjelberimit", pra ju nuk keni ofruar kontrata për shërbimin e gjelberimit".

Lidhur me pretendimin e dytë: Operatori ankimes ka paraqitur kontrata si më poshtë : I- Kontrata shitje mjetesh me kusht Nr.1367 Rep , date 12.07.2018 midis shoqerise " Alkoimpex General Constraction" shpk dhe "Rej " shpk dhe bashkangjitur janë dokumentat shoqeruese të mjeteve sipas lidhjes si më poshtë :

-Mjeti me targa AA 633 PB ,APV,(automjet me përdorim të veçantë) me kapacitet mbajtes 12.57 ton.

-Mjeti me targa AA634PB , APV,(automjet me përdorim të veçantë) me kapacitet mbajtes 12.57 ton.

-Mjeti me targa AA631PB , APV ,(automjet me përdorim të veçantë) me kapacitet mbajtes 5.8 ton.

-Mjeti me targa AA539TI ,APV, (automjet me përdorim të veçantë) me kapacitet mbajtes 6.8 ton.

-Mjeti me targa AA344UB , ATP,(automjet për transport të perzejre),me kapacitet mbajtes 550 kg .

-Mjeti me targa AA538TI, ATP,(automjet për transport të perzejre), me kapacitet mbajtes 520 kg .

-Mjeti me targa AA589MS, me kapacitet mbajtes 3 ton, kamion

-Mjeti me targa AA618GM , ATP,(automjet për transport të perzejre), me kapacitet mbajtes 1.65 ton.

-Mjeti me targa AA675PI , ATP,(automjet per transport te perzejre), me kapacitet mbajtes 1.41 ton .

-Mjeti me targa AA449OE , me kapacitet mbajtes 4.9 ton kamion vetshkarkues

-Mjeti me targa AA537TI , me kapacitet mbajtes 5.5 ton kamion vetshkarkues

-Mjeti me targa AGMT 47 ,fshesa mekanike.

-Mjeti me targa AA593MS , APV,(automjet me perdorim te veçante),me kapacitet mbajtes 8.97 ton.

-Mjeti me targa AA588MS, APV,(automjet me perdorim te veçante),bot uji me kapacitet 4000 litra.

KSHA gjate shqyrtimit te mjeteve te lidhur nga kontrata e mesiperme konstaton se palet kane bere nje kopjim te mjeteve qe ka kerkuar AK sipas se ciles ato do te jene object shitje me kusht ,por për te cilat nuk ka asnje percaktim apo ndarje te qarte se kush eshte mjet teknologjik dhe kush mjet transport kontenieresh e kush mjet vetshkarkues e kush makine per larje rruges apo vaditje ne perputhje me specifikimet teknike per çdo mjet te cituara me sipër. Ku shume qarte ne dst eshte percaktuar se ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/ Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve. Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbainë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.

II.Kontrata e qirase date 13.07.2018 midis Flamur Hoxhaj dhe “Rej” shpk nuk eshte e lidhur para noterit por ka te percaktuar llojin e mjetit (fadrome me goma) , tipin(JCB) dhe targa e tij(ACMT13) cope 1(nje) ashtu siç kerkohet ne DST nga Autoriteti Kontraktor

III.Kontrata e qirase Nr.1366 Rep , date 12.07.2018 midis shoqerise “ Ante Grup” dhe “ Rej” shpk dhe dokumentat shoqeruese te mjeteve si meposhte:

-Mjeti me targe AA147TJ ,APV (automjet me perdorim te veçante) kapacitet 10.4 ton ne pronesi Albanian Leasing.

-Mjeti me targe AA146TJ ,APV (automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 10.4 ton ne pronesi te Albanian Leasing

-Mjeti me targa AA312TM kapacitet 3.28 ton ne pronesi te Ante group ,kamion.

-Mjeti me tagra AA783OF me kapacitet 2.59 ton ne pronesi te Infnit Construction ,kamion.

-Mjeti me targa AA852TI , APV(automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 5.19 litra ne pronesi te Albanian Leasing.

-Mjeti me targa AA525TI , APV (automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 8150 litra ne pronesi te Albanian Leasing date 28.03.2018 , siguruar nga Ante Group ne 29.01.2018 dhe nga ngjyre e verdhe ne dokumenta eshte e bardhe ne fakt.

Kontrata e qirasë Nr.1366 Rep , date 12.07.2018 midis shoqerise “ Ante Grup” dhe “ Rej” shpk se pari ka parregullsi ne formulimin e saj sepse: -Nuk kemi nje kontrate qeraje por nje kontrate nenqeraje; -ne kontrate percaktohet se : Qiradhenesi eshte pronar i ligjshem i makinerive te meposhteme te cilat vertetohen nga lejat e qarkullimit te secilit bashkangjitur kur ne fakt nuk jane ne pronesi te tij ( vetem nje mjet ) dhe jepen me qira mjete qe nuk jane ne pronesi te shoqerise “Ante group”,por qe kjo e fundit i ka marre me qera nga Albania

LEASING sh.a .( MJETET APV). Gjithashtu KSHA konstaton se nuk kemi nje kontrate qeraje mes « ANTE-GRUP » dhe REJ SHPK por nje kontrate nenqeraje sepse kontrata e qerese eshte lidhur mes « ALBANIA LEASING » SHA dhe “Ante Grup” shpk ,date 05.04.2018. Gjithashtu KSHA referuar dates se lidhjes se kontrates se qerese mes “ Albania Leasing “ sh.a dhe « Ante Grup » shpk 05.04.2018 afatit te kontrates 5 vjet (60 muaj), Autorizimit te dhene nga Albania Leasing sha e cila autorizon “Ante Grup” shpk date 12.07.2018, qe ti jape me nenqera “Rej” shpk por qe afati e nenqerese nuk do te jete me i gjate se afati i qerese. Nga sa me siper kontrata e nenqerese per mjetet APV te cituara me siper nuk jane te vlefshme per te gjithë periudhen e e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi ( 5 vjet nga data e lidhjes se kontrates), siç kerkohet ne dokumentat e tenderit. Ashtu si theksuam me siper qe kontrata e nenqerese do te jete sa ajo e qerese 5 vjet 60 muaj Data e kontrates se qerese eshte 05.04.2018 dhe perfundon ne date 05.04.2023, rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. Komisioni i shqyrtimit te Ankesave arsyeton se: 1.Operatori ankimues OE REJ shpk nuk ka paraqitur nje deklarate me shkrim per disponimin e mjeteve ku te specifikohet i detajuar lloji I mjetit, për se do përdoret , targa e tij , të dhënat teknike të mjeteve , me qira /në pronësi/apo lloj tjetër sipas kërkesave në dst dhe specifikimeve teknike pjesë e këtyre dokumentave. 2. Operatori “ REJ “ shpk deklaratën ku Autoriteti Kontraktor rezervon te drejtën të ktyejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e zyre nuk e ka te sakte se deklaror qe mjetet ndodhen ne Xhafzotaj ne nje kohe qe i ka me kontrate shitje me kusht ose me qira . 3. Operatori “ REJ” shpk ka lidhur kontratë qeraje me Shoqerine ANTE-Grup jo te regullt. 4. Gjithashtu nga verifikimi i mjeteve te marra me qera dhe shitje me kusht te cituara me siper sipas ndarjes sonë rezulton se mungojnë : -Dy mjete teknologjik ( 5 ton) mjetet e paraqitura janë mbi 5 ton; -Dy mjete teknologjik e 1.5 -2 ton; - Mungon mjete makine per larjen e rrugeve(autobot) te paisur me pompe per larjen e rrugeve me kapacitet 8000 litra; -Kontrata e qerese per mjetet: me targa AA852TI APV dhe AA525TI ,APV, perfundon para perfundmit te kontrates qe do te lidhet per realizimin e objektit.

Lidhur me pretendimin e tretë: vërejmë se operatori ankimues edhe në ankesën e tij i referohet legjislacionit vetëm përsa i përket menaxhimit të mbetjeve në stacionet e transferimit , ku edhe pika 5.6 pastrim , larje sprucim ose veshje e mbetjeve te amballazheve /paketimeve ose kontinjerëve në menyrë që të ripërdoren i korespondon pikërisht menaxhimit të mbetjeve në të gjitha instalimet. 1. Nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar : Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme). d. Leje mjedisore e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per pastrimin, larje rruges, fshirje rruges . (Kodi III.1.A). e. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) lidhur me ndikimin ne mjedis te leshuar nga QKL.(Kodi III.2.A). f. Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim te mbetjeve urbane te leshuar nga QKL.(Kodi III.2.B). Nga sa më sipër është përgjegjësi i OE të vërtetojë disponimin e këtyre lejeve mjedisore , Neni 34/4, i ligji Nr, 8934 date



05.09.2002 ” Per mbrojtjen e mjedisit ” thekson . Deklarata mjedisore, leja miedisore, pëlqimi dhe autorizimi janë dokumente zyrtare që përcaktojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e miratuar për parandalimin dhe pakësimin e ndikimeve të saj në mjedis. Gjithashtu neni 23/ç i ligjit nr 10081 date 23.02.2009 “ Per licencat , autorizimet dhe lejat ne Republiken e Shqiperise parashikon se : leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna llojin e veprimtarisë, veprimi apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj. Konkluzione : Ne rastin konkret OE nuk ka paraqitur Lejen mjedisore e leshuar nga QKL per veprimtarine e kerkuar pastrimin larje rruges, fshirje rruges (kodi III.1.A).

Lidhur me pretendimin e katërt: Operatori ankimes pretendon se plotëson kriterin 3.2/5 sepse punonjesja E T disponon marrëdhënie të rregullta pune me shoqërinë duke figuruar në listë pagesa e cila me mbarimin e lejës së lindjes ka të drejtë të kthehet në vendin e punës. Konkluzion :Pra edhe nga OE pranohet që E T në neriudhën Gusht-2017 Janar-2018 është me lejë lindje dhe nuk është në punë por mjeku eshte sherbim i specializuar ne Subjektin REJ sh nuk dhe duhet te zevndesohet me mjek tjetër. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë.[...]”

II.7.Në datën 20.08.2018 operatori ekonomik ankimes ”Rej” sh.p.k. ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt me ankesën e paraqitur në autoritetin kontraktor, për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, duke argumentuar si më poshtë vijon:

“[...]Në plotësim të kriterit të mësipërm të kualifikimit shoqëria jonë ka dorëzuar në këtë

procedurë prokurimi -Kontratë datë 16.01.2015 lidhur mes bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk & “Shpresa” shpk te perfaqesuar nga shoqëria “Rej” shpk dhe autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec me objekt kontrate "Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit ” -Vërtetim nr.4634/1 protokollit datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec me përmbajtje "Në përgjigje të kërkesës suaj me lëndë “ Kërkesë për vërtetim realizimi me sukses" nr. 4634 datë 26.06.2018 konfirmojmë se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, më datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit në qytetin e Pogradecit, në bazë të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Vlera e realizuar e këtij shërbimi për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore. Kjo kontratë është përmbushur me sukses nga operatori ekonomik “Rej” shpk. -Kontrate lidhur me Komuna Udenisht shoqeruar me dokumentacionin perkates. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” te ndryshuar parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; Në nenin 28 “Kontrata e Shërbimeve” pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave :Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më e madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjate tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm futura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në arsyetimin mbi skualifikimin e ofertës së shoqërisë tonë në drejtim të kontratave të ngjashme ka arsyetuar si në lidhje me kontratën e dorëzuar me autoritet kontraktor komuna Udenisht ashtu edhe kontratën e sipërcituar lidhur me bashkinë Pogradec. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit mbi dëshminë e eksperiencës konstatojmë se referuar kritereve të kualifikimit autoriteti kontraktor ka parashikuar se dëshmia e eksperiencës së mëparshme duhet të përmbushë 3 kushte kumulative duke nisur nga vlera e shërbimeve të kryera, periudhën e kryer të shërbimeve dhe faktin se shërbimi është përfunduar me sukses. Në rastin konkret të tre kushtet e

mësipërme plotësohen vetëm me një kontratë, kontratën e lidhur me Bashkinë Pogradec për të cilën janë dorëzuar edhe i gjithë dokumentacioni në përputhje me kriteret e veçanta të kualifikimit. Referuar arsyes së skualifikimit, konstatojmë se nga ana e autoritet kontraktor janë parashtruar pretendime si më poshtë vijon: “Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec date 16.01.2016 ka të percaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive ”Rej ” sh.p.k. dhe ”Shpresa” sh.p.k, dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anetareve ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec Nr.4634/1 prot. , date 26. 06.2018 nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontrate është realizuar me sukses dhe I vetëm nga shoqëria ”Rej ” sh.p.k. (në kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 të ndryshuar neni 74, pika 2 , Bashkimi 1 Operatoreve ekonomike) edhe pse në kontratën e lidhur është percaktuar qarte që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë ”Rej ” sh.p.k. ” Në lidhje me pretendimet e mësipërme të autoritetit kontraktor, së pari sqarojmë se kontrata është lidhur me institucionin e Bashkisë Pogradec, organ publik juridik, njësi e qeverisjes vendore, i cili ashtu siç thotë edhe neni 12 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar është përgjegjës për zhvillimin zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të kontratave publike. Gjithashtu, detyrimi dhe ngarkimi nga ligji për monitorimin e kontratave publike i ngarkohet autoritetit kontraktor edhe nga neni 62 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" të ndryshuar. Në rastin konkret, sqarojmë se kontratë datë 16.01.2015, për të cilën parashtrohen edhe pretendime është lidhur mes bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk & “Shpresa” shpk të përfaqësuar nga shoqëria “Rej” shpk dhe autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec me objekt kontrate “Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit”. Kontrata e mësipërme është zbatuar vetëm nga shoqëria “Rej” shpk e cila nuk shfaqet vetëm në cilësinë e përfaqësuesit të grupit në këtë kontratë, por shoqëria e cila ka kryer në masën e njëqind përqind të shërbimeve të kërkuara të kontratës nga momenti i lidhjes së saj dhe në vazhdim. Vetë autoriteti kontraktor në lidhje me këtë çështje ka lëshuar edhe Vërtetim nr.4634/1 protokolli datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec me përmbajtje “Në përgjigje të kërkesës suaj me lëndë “ Kërkesë për vërtetim realizimi me sukses" nr.4634 datë 26.06.2018 konfirmojmë se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, më datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit në qytetin e Pogradecit, në bazë të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Vlera e realizuar e këtij shërbimi për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore. Kjo kontratë është përmbush me sukses nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Nënvizojmë se ka diferencë logjike dhe ligjore të dy momenteve të ndryshme procedurale, asaj të dorëzimit të dokumentacionit në një procedurë prokurimi në cilësinë e një bashkimi operatorësh ekonomikë dhe të zbatimit të kontratës konkrete, në përputhje me kushtet dhe rrethanat e parashikuara nga ligji. Kuadri ligjor në fuqi, neni 44 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar

parashikon se grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm. Autoriteti kontraktor duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit. Konkretisht, marrëdhëna e secilit anëtar si në fazën, e shqyrtimit dhe vleresimit të ofertave ashtu edhe në zbatimin e kontratës në rastin e dorëzimit të ofertave nga grupe operatorësh ekonomik rregullohet nga rregullat e prokurimit publik miratuar me anë të aktit në zbatim të ligjit Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar. Konkretisht, neni 74 i këtyre rregullave sqaron marrëdhënien gjatë zbatimit të kontratës. Në nenin 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar parashikohet se: "5.Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat." Në rastin konkret, ashtu sikundër pasqyrohet prima facia edhe në përmbajtje të Vërtetimit nr.4634/1 protokollit datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec, Bashkia Pogradec në cilësinë e palës gjatë zbatimit të kontratës ka konstatuar se një prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë në atë procedurë dhe palë të kontratës, shoqëria Shpresa shpk gjendet në kushtet dhe rrethanat që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës e për rrjedhojë në përbushje të nenit 74 pika 5 të aktit nënligjor ka vijuar me zbatimin e kontratës me operatorin tjetër ekonomik, palën tjetër në kontratë shoqërinë "Rej" shpk e cila jo vetëm ka marrë përsipër kryerjen e punimeve por ka realizuar me sukses kontratën. Procesi i zbatimit të detyrimeve në tërësi të kontratës nga ana anëtarit tjetër të këtij bashkimi dhe konkretisht shoqërisë "Rej" shpk është zhvilluar në përputhje me të gjithë kuadrin ligjor në fuqi, një proces i cili është aprovuar nga ana e autoritetit kontraktor në përputhje me nenin 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar dhe mbi të gjitha që nuk ka patur asnjë kundërshtim nga anëtarit tjetër i perkohshëm të shoqërive në atë kontratë. Theksojmë se ka një dallim të qartë dhe esencial, logjik dhe ligjor mbi momentin e dorëzimit të ofertave në një procedurë prokurimi në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të kontratës nga ana tjetër, mbi të gjitha kur zbatimi i kontratës në masën 100 % nga anëtarit tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe është deklaruar me akt që në momentin e dorëzimit të ofertave nga shoqëria jonë. Bazuar në parimin e transparencës dhe duke qenë të vetëdijshëm për detyrimet që rrjedhin nga neni 82 pika 1 e ligjit nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar ku parashikohet se: "Në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e proves për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit

publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj. " në cilësinë e një procedure të nisur kryesisht, duke dashur të vendosim të gjithë dokumentacionin ligjor për të shqyrtuar në përputhje me ligjin të ankesës sonë nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave, iu drejtuar me një kërkesë me shkrim kontraktorit Bashkisë Pogradec ku i kërkuam informacion lidhur me kontratën e mësipërme (kopje të kërkesës e gjeni bashkëngjitur) në zbatim të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" Në datën 06.08.2018 me anë të shkresës nr.5917/1 prot datë 06.08.2018, Bashkia Pogradec ndër të tjera ka sqaruar shoqërinë tonë se: " Në datën 16.01.2015 është lidhur kontrata e shërbimit me objekt "Pastrim, grumbullim dhe largim I mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit. Kontrata është lidhur me shoqëritë "Rej" shpk dhe "Shpresa" shpk, përfaqësuar nga shoqëria "Rej" shpk. Në lidhje me kërkesën tuaj mbi përqindjen e kryerjes së shërbimit dhe zbatimit të kontratës nga secili operator ekonomik, ju informojmë se duke nisur nga data 17.01.2015 e në vijim, kontrata është realizuar e plotë në të gjithë vlerën e deklaruar të saj prej 107,687,190 lekë pa TVSH vetëm nga shoqëria "REJ" shpk me NUIS J93711608Q. Shërbimi i pastrimit të qytetit të Pogradecit është kryer në përputhje me kushtet e kontratës dhe detyrimet janë marrë përsipër vetëm nga shoqëria "Rej" shpk në zbatim të parashikimeve ligjore, kushteve dhe rrethanave të përcaktuara nga neni 74 pika 5 e Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar. Në lidhje me vlerën totale të shërbimit, sqarojmë se për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018, vlera e shërbimit të ofruar është 105,047,372 (Njëqind e pesë million e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore, ndërsa për periudhën 31 Maj 2018 e në vijim është realizuar vlera 107,687,190 lekë pa TVSH. Bazuar në ligjin nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit ju sqarojmë se nga ana e Bashkisë Pogradec është trajtuar edhe kërkesa për informacion nr.2850 protokollit datë 24.07.2018 protokolluar pranë institucionit tonë në datë 26.07.2018 me nr 5656 protokollit hyrës datë 26.07.2018 e Bashkisë Maliq. Kërkesa e mësipërme lidhet mbi angazhimin e shoqërisë tuaj në kontratën e sipërcituar, për të cilën Bashkia Pogradec i ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 5656/1 protokollit datë 27.07.2018. Bazuar në nenin 3 pika 3 dhe 14 të ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit" bashkëngjitur lutem gjeni kopje të njëzuar të korenspondencës me institucionin e Bashkisë Maliq. " Referuar shkresës së mësipërme konstatojmë se Komisioni i Vlerësimit të ofertave pranë autoritetit kontraktor ka kryer verifikime bazuar në nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar ku parashikohet se; "Në rast se komisionit të vlerësimit të ofertave i lind nevoja për verifikime ose ndryshime të një apo më shumë anëtarëve, afati i vlerësimit pezullohet në momentin e paraqitjes së kërkesës për verifikim apo ndryshim dhe rifillon aty ku është pezulluar me marrjen e përgjigjes apo zyrtarizimit të anëtarit/anëtarëve. " Në rastin konkret, referuar aktit nr nr.5917/1 prot datë 06.08.2018, Bashkia Pogradec na informon se ka informuar Bashkinë Maliq në lidhje me kërkesën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku sqaruar se kontrata është zbatuar vetëm nga shoqëria "Rej" shpk, pas aprovimit të autoritetit kontraktor/sipërmarrësit në cilësinë e palës në kontratë dhe pas përmbushjes së kushteve kumulative të parashikuar nga neni 74 pika 5 e Vendimit nr.914

datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. (bashkëngjitur korrespondenca midis Bashkisë Pogradec dhe Bashkisë Maliq). Sa më sipër, KVO nuk ka marrë në konsiderarë rezultatet e verifikimit të kryer në zbatim të ligjit. Gjithashtu, konstatojmë se në arsyetimin e vendimit të tij, Komisioni i Vlerësimit të ofertave ka kapërcyer tagrat e përcaktuara nga neni 58 i Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave prokurimit publik të ndryshuar ku parashikohet se: “Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkohen sqarime për dokumentet e tenderit, këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër, përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla”. Në rastin konkret KVO ka tejkaluar kompetencat e dhënë nga ligji kur ka deklaruar se: “Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec date 16.01.2016 ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive “Rej” sh.p.k. dhe “Shpresa” sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anetareve ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec Nr.4634/1 prot., date 26.06.2018 nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontrate është e realizuar me sukses dhe I vetëm nga shoqëria “Rej” sh.p.k. ( në kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 të ndryshuar neni 74, pika 2 , Bashkimi I Operatoreve ekonomike ) edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qarte që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë “Rej” sh.p.k. ” Sa më sipër nuk është në kompetencën e KVO-së të konstatojë shkelje nga një institucion tjetër publik dhe të deklarojë si të pavlefshme kushtet e kontratës rënë dakord mes palëve, e për rjedhojë do të ndodheshim para kushteve të nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative në cilësinë e një akti absolutisht të pavlefshëm të nxjerrë në kushtet e tejkallimit të kompetencave nga ana e autoritetit kontraktor. Gjithashtu, do të donim të sqaronim para Komisionit të Prokurimit Publik, se jo vetëm palët, por edhe rrathanat e faktit, përmbajtja e dokumentacionit të dorëzuar nuk është e njëjtë dhe as e ngjashme me dokumentacionin e dorëzuar në një procedurë tjetër prokurimit të zhvilluar nga Bashkia Korçë, për të cilën është shprehur edhe Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin KPP 378/2018. Sa më sipër, shkurtimisht sqarojmë se: Në vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik KPP 378/2018 ku është gjykuar edhe mbi plotësimin e dëshmisë së eksperiencës së ngjashme nga shoqëria “Rej” shpk pjesë e një bashkimi operatorësh ekonomikë, referuar edhe seksionit III.1.3. të arsyetimit të vendimit të mësipër, rezulton se nga shoqëria jonë “Rej” shpk në këtë procedurë prokurimi është dorëzuar Kontratë datë 16.01.2015 lidhur midis autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk dhe “Shpresa” shpk, me objekt “Pastrimi, grumbullimi dhe largimi i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit”, me qfat 5 vjeçar, me fond limit 198.062.504 lekë me tvsh, fatura tatimore shitje dhe situacione për muajt Janar 2015-Dhjetor 2015, kontratë shtesë e lidhur në datën 31.12.2015, ndërmjet Bashkisë Pogradec dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “Rej” sh.p.k. & “Shpresa” sh.p.k., me afat nga data 31.12.2015 deri në datën 07.01.2018, me vlerë 1.198.178 lekë me tvsh; shoqëruar me faturë tatimore shitje dhe siluacion; -faturat tatimore të shitjes dhe situacionet përkatëse për periudhën Janar 2015- Janar 2018; -Dokumenti “Konfirmim

realizim shërbimi”, lëshuar në datën 18.01.2018, me nr. 79/1 prot., për operatorin ekonomik ”Rej” sh.p.k. nga Bashkia Pogradec, për kontratën e shërbimit të pastrimit për periudhën 17 Janar 2015 - 31 Dhjetor 2017, me vlerë realizimi në shumën 93.398.395 lekë pa tvsh, e cila (citojmë): është realizuar i vetëm nga operatori ekonomik Rej shpk. Për shkaqe të pavarura nga shoqëria jonë vërtetimi i mësipërm i lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk përmbante informacion të plotë në lidhje me realizimin e kontratës nga shoqëria ”Rej” shpk. Rasti aktual nuk mund të konsiderohet i ngjashëm, pasi rrethanat nuk janë të njëjta ndaj dhe gjykimi nuk mund të jetë objektivisht i njëjtë. Në procedurën e prokurimit objekt ankimi, shoqëria jonë ka dorëzuar krahas kontratës edhe Vërtetim nr.4634/1 protokolli datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec me përmbajtje ”Në përgjigje të kërkesës suaj me lëndë “ Kërkesë për vërtetim realizimi me sukses” nr. 4634 datë 26.06.2018 konfirmojmë se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, më datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit në qytetin e Pogradecit, në bazë të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga operatori ekonomik ”Rej” shpk. Vlera e realizuar e këtij shërbimi për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore. Kjo kontratë është përmbush me sukses nga operatori ekonomik ”Rej” shpk. Pra Bashkia Pogradec ka sqaruar pa ekuivok se kontrata është realizuar nga shoqëria ”Rej” shpk në kuadër të një procedure ligjore dhe të miratuar nga autoriteti kontraktor në zbatim të nenit 74 pika 5 të VKM 914/2014. Gjithashtu kemi dorëzuar edhe një shkresë sqaruese lëshuar nga Bashkia Pogradec për shoqërinë tonë, madje dhe informacionin vënë në dispozicion autoritetit kontraktor Bashkia Maliq nga Bashkia Pogradec. Duke qenë se rastet nuk janë as ligjërish dhe as objektivisht të njëjta jemi para një shtate të ndryshme dhe vendimi KPP 378/2018 nuk mund të cilësohet si precedent. Referuar trajtimit të ankesë së shoqërisë tonë me anë të shkresës nr. 3127/1 protokolli datë 15.08.2018 konstatojmë se Komsioni i Shqyrtimit të Ankesave ka arsyetuar si më poshtë vijon: KSHA bazuar në dst ,kerkesat kualifikuese si dhe në kontratat e paraqitura nga OE ”Rej” konstatoi se: Nga verifikimi i ofertës së paraqitur nga OE ” Rej” rezulton se ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme. Në Kontraten e lidhur mes Bashkisë Pogradec dhe Bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k. dhe e firmosur dhe vulosur nga te dy OE ,nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ”Rej” sh.p.k. & ”Shpresa” sh.p.k., në mënyrë që të përlllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria ”Rej” sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec, ka të përcaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i operatorëve ekonomik ”Rej” sh.p.k. dhe ”Shpresa” sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej këtyre anëtarëve dhe ndarja e shërbimeve dhe llojit të tyre sipas kësaj % , sipas nenit 74/2 e VKM Nr. 914 , date 29.12.2014 e ndryshuar. Ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontratë është realizuar i vetëm nga shoqëria ”Rej” sh.p.k.

edhe pse në kontratën e lidhur është përcaktuar qartë që kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë (BOE) dhe jo vetëm me shoqërinë "Rej" sh.p.k. Gjithashtu, edhe vërtetimi Nr.4634/1 ,datë 26.06.2018, e Bashkisë Pogradec ka mangësi, pasi thekson se: Në zbatim të kontratës së sipërmarjes me datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit të qytetit Pogradec në bazë të nenit 74 , pika 5 , të Vendimit Nr. 914 , date 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave " Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar për periudhë 17 janar 2015 deri më 31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga OE " Rej " shpk dhe nuk jep asnjë shpjegim apo document pse është në kushtet e nenit 74/5 te VKM Nr. 914 si më poshtë: Ne rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të Operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjara që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator ekonomik tjetër, antar i bashkëpunimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Për ndryshe autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëhere detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të meren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një antar tjetër i bashkimit me kusht që ky të plotësojë kërkesat. Ne ankesën e tij Operatori "Rej" shpk nënvizon : Theksojmë se ka një dallim të qartë dhe esencial , logjik dhe ligjor mbi momentin e dorëzimit të ofertave në një procedure prokurimi në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të kontratës nga ana tjetër, mbi të gjitha kur zbatimi i kontratës në masën 100 % nga antari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë është pranuar nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe është deklaruar me akt që në momentin e dorëzimit të ofertave nga shoqëria jonë. Nga sa më sipër nuk ka asnjë document tjetër që të vërtetojë se Operatori tjetër " Shpresa" shpk është në falimentim referuar dhe nenit Nr 24 Nderprerja per shkak te Falimentimit, te kontrates te lidhur ne date 16.01.2015 ndermjet BOE "Shpresa" shpk dhe "Rej" shpk me Bashkinë Pogradec, apo në rrethana të tjera për të cilat Bashkia Pogradec e vazhdon zbatimin e kontratës vetëm me operatorin " Rej " shpk apo ndonjë akt deklarimi të pranuar nga bashkia Pogradec që në momentin e dorëzimit të ofertave .Po të kishte një document të tillë ai duhet të ishte paraqitur ne SPE sepse bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i RSH", barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Shtrojmë pyetjen -Si ka mundesi qe nga njera ane na paraqitet nje kontrate e lidhur me bashkim te O.E Rej shpk dhe Shpresa shpk dhe nga ana tjeter na paraqitet nje vertetim ku citohet se sherbimi eshte kryer i vetem nga OE Rej shpk. -Kur i plotësoi operatorin " REJ" shpk kërkesat e vendosura nga Bashkia Pogradec një ditë pasi ka lidhur kontratën me këtë të fundit ? Bashkia Pogradec në përgjigjen që i kthen KVO ka dështuar në dhënien e informacionit të kërkuar sepse duhet të kishte argumentuar dhe dokumentuar pse zbatimi i kontratës bëhet vetëm nga Operatori "REJ" shpk dhe jo një përgjigje të shkurtër se Sherbimi i pastrimit te qytetit te Pogradecit eshte kryer ne perputhje me kushtet e kontratës dhe detyrimet jane marre persiper vetem nga shoqeria " REJ" shpk në zbatim të parashikimeve ligjore , kushteve dhe rethanave të përcaktuara nga neni 74 , pika 5 e VKM -së Nr 914 , datë 29.12.2017 , të ndryshuar . Lidhur me kontratën e realizuar me Komunën Udënisht, theksojme se OE nuk arrin të



përbushë kriterin për kontrata të ngjashme, pasi nuk plotëson vlerën e kërkuar, (sipas shkresës 349/1 datë 20.02.2018 të Bashkisë Pogradec zbatimi i kontratës për shërbimin e pastrimit dhe largimit të mbeturinave urbane nga Komuna Udënisht për periudhën 30 Prill 2012 deri në 30 Prill 2017 është realizuar nga OE "Rej" shpk vlera e realizuar për këtë shërbim është 11,549,734 lekë pa tvsh sipas situacioneve mujore. Kjo kontratë është realizuar me sukses nga OE " Rej " shpk . Pra vlera e realizuar në pesë vjet është 11,549,734 lekë kurse në tre vitet e undit 6,929,840 lekë. Konkluzion : sa më sipër, 1. Kontratat e paraqitura nuk mund të merren në konsideratë për shkak të mangësive dhe konkretisht: a. Tek kontrata e lidhur nga BOE REJ shpk dhe Shpresa shpk me Bashkinë Pogradec mungon përqindja e bashkepunimit që ka secili operator ekonomik në këtë bashkim operatorësh, me qëllim që të bëhet përlllogaritja e shërbimeve të kryera nga REJ shpk e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit, dhe nuk ka asnjë dokument apo amendament që verteton se Bashkia Pogradec ka lidhur me OE "REJ" shpk për të realizuar e vetme zbatimin e kontratës. b. Tek kontrata e lidhur ndërmjet REJ shpk dhe Komunes Udenisht ,vlera e kontratës së realizuar është poshtë vlerës së kërkuar në dokumentat e tenderit 2. Kontratat e paraqitura nga OE "REJ" shpk me objekt pastrimin dhe largimin e mbeturinave urbane nuk përmbushin kërkesat e pikës 3.2 pika 1.a për shërbime të ngjashme në të gjithë elementet e objektit që tenderohet "Shërbime të pastrimit dhe gjelberimit", pra ju nuk keni ofruar kontrata për shërbimin e gjelberimit". Në lidhje me pretendimin e parë të ngritur nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave se: "nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomike "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k., në mënyrë që të përlllogaritet pjesa e shërbimeve të kryera nga shoqëria "Rej" sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.", sqarojmë se, informacioni i mësipërm do të ishte i nevojshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Maliq, në rast se kontrata do të ishte realizuar në tërësi nga bashkimi i operatorëve ekonomikë "Rej" shpk & "Shpresa" shpk, ndërkohë në rastin konkret, referuar të gjithë vërtetimeve të lëshuara në vijimësi nga Bashkia Pogradec (arsyetuar sa më sipër) rezulton se megjithëse kontrata është lidhur mes bashkimit të operatorëve ekonomikë, me miratim paraprak të autoritetit kontraktor dhe në zbatim të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" të ndryshuar ku parashikohet se: "5. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat."

Kontrata është zbatuar vetëm nga shoqëria "Rej" shpk. Në rastin konkret, kontrata cilësohet e zbatuar vetëm nga një operator ekonomik dhe informacioni mbi përqindjen e

*bashkëpunimit nuk ka asnjë vlerë në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Në lidhje me pretendimin e dytë të ngritur nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave pranë Bashkisë Maliq me argumentin se: “Gjithashtu, edhe vërtetimi Nr.4634/1 ,datë 26.06.2018, e Bashkisë Pogradec ka mangësi, pasi thekson se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes me datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit të qytetit Pogradec në bazë të nenit 74 , pika 5 , të Vendimit Nr. 914 , date 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “ Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar për periudhë 17 janar 2015 deri më 31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga OE “ Rej “ shpk dhe nuk jep asnjë shpjegim apo document pse është në kushtet e nenit 74/5 te VKM Nr. 914 si më poshtë: Ne rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të Operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjara që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator ekonomik tjetër, antar i bashkëpunimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Për ndryshe autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëhere detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të meren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një antar tjetër i bashkimit me kusht që ky të plotësojë kërkesat. Ne ankesën e tij Operatori “Rej” shpk nënvizon : Theksojmë se ka një dallim të qartë dhe esencial , logjik dhe ligjor mbi momentin e dorëzimit të ofertave në një procedure prokurimi në cilësinë e bashkimit të operatorëve ekonomikë dhe zbatimit të kontratës nga ana tjetër, mbi të gjitha kur zbatimi i kontratës në masën 100 % nga antari tjetër i bashkimit të operatorëve ekonomikë është pranuar nga ana e Autoritetit Kontraktor dhe është deklaruar me akt që në momentin e dorëzimit të ofertave nga shoqëria jonë. Nga sa më sipër nuk ka asnjë document tjetër që të vërtetojë se Operatori tjetër “ Shpresa” shpk është në falimentim referuar dhe nenit Nr 24 Nderprerja per shkak te Falimentimit, te kontrates te lidhur ne date 16.01.2015 ndermjet BOE “Shpresa“ shpk dhe “Rej” shpk me Bashkine Pogradec, apo në rrethana të tjera për të cilat Bashkia Pogradec e vazhdon zbatimin e kontratës vetëm me operatorin “ Rej “ shpk apo ndonjë akt deklarimi të pranuar nga bashkia Pogradec që në momentin e dorëzimit të ofertave .Po të kishte një document të tillë ai duhet të ishte paraqitur ne SPE sepse bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë. Shtrojmë pyetjen -Si ka mundesi qe nga njera ane na paraqitet nje kontrate e lidhur me bashkim te O.E Rej shpk dhe Shpresa shpk dhe nga ana tjeter na paraqitet nje vertetim ku citohet se sherbimi eshte kryer i vetem nga OE Rej shpk. -Kur i plotësoi operatori “ REJ” shpk kërkesat e vendosura nga Bashkia Pogradec një ditë pasi ka lidhur kontratën me këtë të fundit ? Bashkia Pogradec në përgjigjen që i kthen KVO ka dështuar në dhënien e informacionit të kërkuar sepse duhet të kishte argumentuar dhe dokumentuar pse zbatimi i kontratës bëhet vetëm nga Operatori “REJ” shpk dhe jo një përgjigje të shkurtër se Sherbimi i pastrimit te qytetit te Pogradecit eshte kryer ne perputhje me kushtet e kontratës dhe detyrimet jane marre persiper vetem nga shoqeria “ REJ” shpk në zbatim të parashikimeve ligjore , kushteve dhe rethanave të përcaktuara nga neni 74 , pika 5 e VKM -së Nr 914 , datë 29.12.2017 , të ndryshuar*

nënvizojmë se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka tejkaluar tagrat e dhënë nga ligji. Së pari, theksojmë se si rregull vendimarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave është një vendimarrje e kufizuar në objektin e ankesës, pretendimet e palëve dhe që bazohet në dokumentet dhe provat që disponohen. Vendimarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, nuk është edhe nuk mund të jetë një vendimarrje e ngritur mbi hipoteza, pyetje apo pretendime apriori. Vendimarrja e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në cilësinë e një organi kolegjal të posaçëm të ngritur për trajtimin e ankesës tonë duhet ti nënshtrohet parimit të ligjshmërisë. Në nenin 4 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative ne Republikën e Shqipërisë ” parashikohet se: “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca. 2. Të drejtat apo interesat e ligjshëm të një pale nuk mund të cenohen nga veprimi administrativ, përveç se kur parashikohet nga ligji dhe duke respektuar një proces të rregullt ligjor. Në rradhë të parë, është jashtë kompetencave të institucimit të Bashkisë Maliq të gjykojë, vlerësojë mbi ligjshmërinë e akteve të një institucioni tjetër të qeverisjes vendore. Shoqëria jonë nuk mund të disponojë barrën e provës për të dokumentuar veprime të brendshme institucionale të Bashkisë Pogradec, përsa kohë që ne, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi kemi vënë në dispozicion një dokument zyrtar të lëshuar nga Bashkia Pogradec, ku jepet i gjithë informacioni i kërkuar në përputhje me dokumentet e tenderit dhe i nevojshëm për procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave në një kuadër vendimarrjeje të një procedure të prokurimit publik. Nënvizojmë se ndër parimet kryesore ligjore është ai sigurisë juridike, i cili thekson në besueshmërinë e akteve dhe vendimeve të nxjerra nga organet e administratës publike. E rëndësishme për KSHA dhe tashmë për KPP është momenti procedural se nga cili operator ose grup operatorësh është zbatuar kontrata dhe jo procedura e brendshme e një institucioni, i cili mban përgjegjësi ligjore për vendimarrjen e tij. Pa asnjë ekuivok në më shumë se 3 shkresa të lëshuara enkas për këtë procedurë prokurimi, Bashkia Pogradec ka nënvizuar se kontrata është përmbushur nga shoqëria “Rej” shpk në zbatim të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullve të prokurimit publik” të ndryshuar. Së dyti, pyetjet e ngritura se Kur i plogosoi operatori " REJ" shpk kerkesat e vendosura nga Bashkia Pogradec nje dite pasi ka lidhur kontraten me kete te fundit është jashtë kompetencave të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave të Bashkisë Maliq, pasi vlerësimi i kushteve të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar është tagër i vetëm i autoritetit kontraktor, palë në kontratë Bashkia Pogradec. Nënvizojmë se vendimarrja administrative nuk bazohet në hipoteza, pyetje apo deduksione, por në prova, fakte dhe akte ligjore të lëshuara nga institucione që kanë kompetencën lëndore, materiale dhe tagrat e lëshimit të aktit në fjalë. KSHA, për herë të parë pranon se nga ana e KVO është kërkuar informacion nga Bashkia Pogradec por parashtron pretendimin se ky informacion është i pa mjaftueshëm. Së pari, nënvizojmë se informacioni i paraqitur nga Bashkia Pogradec në gjykimin tonë përmban të gjithë informacionin e kërkuar dhe të nevojshëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Së dyti, në rast se KVO ose edhe KSHA

do të gjykonte se informacioni i mësipërm është i pa mjaftueshëm atëherë ka patur në dispozicion mundësinë të kërkonte sërish informacion pranë Bashkisë Pogradec veprim cili nuk është kryer. Në mungesë të plotë të logjikës dhe logjikës ligjore, KSHA pretendon se duhet të ishte dorëzuar informacion në përputhje me parashikimet e nenit 74 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, por anashkalon parashikimet e nenit 74 pika 5. Së fundmi, konstatojmë se KSHA ka tejkaluar tagrat e dhënë nga ligji duke ngritur pretendime shtesë skualifikimi të pa njoftuara në SPE kur ngre pretendimin se: “2. Kontratat e paraqitura nga OE “REJ” shpk me objekt pastrimin dhe largimin e mbeturinave urbane nuk permbushin kerkesat e pikës 3.2 pika 1.a per sherbime te ngjashme ne te gjithë elementet e objektit qe tenderohet “Sherbime te pastrimit dhe gjelberimit”, pra ju nuk keni kontrata per sherbimin e gjelberimit”. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ““Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtanri i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gjënia “ç” të Vendimit Nr.914 dt.29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se : [...]Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është

përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrlari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave. b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj. c) Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti kontraktor ta sigurojë këtë informacion. ç) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit [...]" Tashmë në vendimarrjen e konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik është mbajtur qëndrimi se KSHA dhe KPP nuk mund të ngrejë pretendime shtesë skualifikimi dhe konkretisht KPP 622/2016 KPP ka arsyetuar se:... **(citim vendimi KPP 622/2016)**

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin 450/2017 ku është shprehur se:... **(citim vendimi KPP 450/2017)**

Kështu, nënvizojmë se vlerësimi i mësipërm mbi ngjashmërinë e kontratës është kryer në mënyrë sipërfaqësore dhe nuk paraqet një analizim në thelb të kontratës së dorëzuar. Megjithatë në shkëlqje të ligjit, sërish KSHA ka konstatuar mbi ngjashmërinë e kontratës vetëm bazuar mbi titullin e saj dhe nuk i është referuar në asnjë rast thelbit të kontratës. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës ka parashikuar dorëzimin e kontratës së lidhur dhe vërtetimit të realizimit. Autoriteti kontraktor pretendimin se kontrata e mësipërme nuk përmban shërbime të mirëmbajtjes gjelbërimi është një pretendim i ngritur a-priori dhe i pa mbështetur në fakt. Kontrata e mësipërme e dorëzuar nga shoqëria jonë, është kontratë e ngjashme referuar nenit 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të" prokurimit publik". Me keqdashje autoritetit kontraktor i referohet termit kontratë e së njëjtës natyrë, kur vetë kuadri ligjor në çdo moment parashikon se dëshmia mbi kontratat e mëparshme lidhet mbi ngjashmërinë e tyre. Gjithashtu me anë të dokumentacionit të dorëzuar kemi dëshmuar se kontrata është e ngjashme ku përfshihet njëherazi edhe shërbime gjelbërimi. Sa më sipër arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.

Në shtojcën mbi ndryshimin e "Kritereve të Veçanta të Kualifikimit " "Kapaciteti Teknik" në zbatim të Vendimit të KPP 407/2018 të dokumenteve të procedurës së prokurimit është parashikuar: 3.2 Kapaciteti teknik: 11. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës: -Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës garanton që mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto (të qarta) për secilin mjet sipas listës së mëposhtme...

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë: - Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesis origjinal ose

*kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi). -Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesis se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi). - Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve. Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj. -Per mjete qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme). -Per mjetet me qera, me Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin certifikaten e kontrollit teknik siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/fumizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre. Në plotësim të kriterëve të veçanta të kualifikimit shoqëria jonë ka dorëzuar: Deklaratë Mbi verifikimin e mjeteve me përmbajtje si mëposhtë vijon: **DEKLARATE PER MJETET E operatorit ekonomik pjesëmarrës ne Proceduren e Prokurimit Publik, qe do te zhvillohet ne date 17.07.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Maliq me objekt "Shërbime të Pastrimit dhe Gjelberimit" me fond limit 139.642.150 (Njeqind e tridhjete e nente milion e gjashtëqind e dyzete e dy mije e njeqind e pesedhjete) lek pa TVSH. Une i nenshkruari LUAN KAPRI me cilesine e ADMINISTRATORIT te operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k deklarorj se Autoriteti Kontraktor Rezervon te drejten te kryeje ne cdo kohe verifikimin fizik te disponueshmerise se mjeteve me apo pa lajmerim paraprak. Adresa e mjeteve me qellim verifikimin e tyre eshte ne seline kryesore te Operatorit ekonomik REJ sh.p.k: Xhafzotaj Durrës. -Deklaratë se mjetet nuk janë angazhuar në kontrata të tjera me përmbajtje si më poshtë vijon: E operatorit ekonomik pjesëmarrës ne Proceduren e Prokurimit Publik, qe do te zhvillohet ne date 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt "Sherbime te Pastrimit dhe Gjelberimit " me fond limit 139.642.150 ( Njeqind e tridhjete e nente milion e gjashtëqind e dyzete e dy mije e njeqind e pesedhjete ) lek pa TVSH. Une i nenshkruari LUAN KAPRI me cilesine e ADMINISTRATORIT te operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k deklarorj dhe garantoj se mjetet teknologjike nuk jane te angazhuara ne kontrata te tera. - Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të mjeteve me përmbajtje si më poshtë vijon: E operatorit ekonomik pjesëmarrës ne Proceduren e Prokurimit Publik, qe do te***

zhvillohet ne date 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt "Sherbime te Pastrimit dhe Gjelberimit " me fond limit 139.642.150 (Njeqind e tridhete e nente milion e gjashteqind e dyzete e dy mije e njeqind e pesedhete ) lek pa TVSH. Une i nenshkruari LUAN KAPRI me cilesine e ADMINISTRATORIT te operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k deklaroj se mjeret e paraqitura jane ne perputhje me specifikimet teknike pjese perberese e ketyre dokumenta tenderi. Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve si më poshtë vijon: E operatorit ekonomik pjesemarrës ne Proceduren e Prokurimit Publik, qe do te zhvillohet ne date 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt "Sherbime te Pastrimit dhe Gjelberimit " me fond limit 139.642.150 ( Njeqind e tridhete e nente milion e gjashteqind e dyzeta e dy mije e njeqind e pesedhete ) lek pa TVSH. Une i nenshkruari LUAN KAPRI me cilesine e ADMINISTRATORIT te operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k deklaroj se mjetet do te jene te disponueshme gjate gjithë periudhes se kryerjes se sherbimit. -Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike. -Kontratë nr. 1367 repertori dhe nr.993 koleksioni datë 12.07.2018 Për shitjen e mjeteve me kusht - Kontratë 1367 repertori dhe nr.993 koleksioni datë 12.07.2018 qera mjetesh. Referuar arsyes së skualifikimit konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor janë ngritur dy pretendime në lidhje me mos dorëzimin e pretenduar të deklaratës mbi disponueshmërinë e mjeteve si edhe në lidhje me kontratat e qerasë dhe të shitjeve me kusht për mjetet e dorëzuar në këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me pretendimin e parë mbi mos dorëzimin e pretenduar të Nuk ka deklarate me shkrim per disponimin e mjeteve ku te specifikohet lloji i mjetit, për se do përdoret , targa e tij , të dhënat teknike të mjeteve,me qira/pronesi /apo lloj tjetër, nënvizojmë se autoriteti kontraktor gabohet në arsyetimin e mësipërm për dy arsye. Së pari deklarata e mësipërme e pretenduar që duhej të dorëzohej është një shtojcë e veçantë në procedurat e prokurimit publik kontratat e punëve publike, si shtojcë mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe të paisjeve, ndërkohë në rastin tonë kemi të bëjmë me kontratë shërbimesh dhe shtojca mbi disponueshmërinë e mjeteve nuk është pjesë e setit as të dokumenteve të miratuar nga Agjencia e Prokurimit Puhik si edhe as të procedurës konkrete të prokurimit. Në shtojcën 8 "Kriteret e veçanta të kualifikimit" është përcaktuar edhe lista e shlojcave të detyrueshme për t'u dorëzuar ku rezulton se janë kërkuar: 1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë: a. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5; b. Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6; c. Formulari i Ofertës, sipas Shtojces1; d. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuaru të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Furnizuesi i energjisë elektrike është i detyruar që ta lëshojë këtë vërtetim jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e depozitimit të kërkesës nga operatori ekonomik. ) Nuk është kërkuar dorëzimi i shtojcës së pretenduar nga autoriteti kontraktor. Së dyti, autoriteti kontraktor gabohet në lidhje me arsyen e mësipërme edhe për vetë faktin se në asnjë pjesë të shtojcës mbi dokumentet e procedurës së prokurimit nuk është kërkuar dorëzimi i një deklarate mbi disponueshmërinë e mjeteve dhe paisjeve me targa, forma e e disponueshmërisë qera/etj sipas pretendimeve të autoritetit kontraktor. Referuar Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit nga ana ane autoritetit kontraktor është kërkuar dorëzimi i katër deklaratave : deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve gjatë

gjithë periudhës së zbatimit të kontratës; deklaratë mbi vendodhjen e mjeteve për qëllime kualifikimi, deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve të mjeteve si edhe deklaratë se mjete nuk janë të angazhuara. Gjithashtu shoqëria jonë ka dorëzuar 5 deklarata edhe shtojcën standarde mbi përmbushjen e specifikimeve teknike në tërësi duke përfshirë edhe specifikimet teknike të mjeteve të kërkuara. Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin public" të ndryshuar Parashikohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit." Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka vlerësuar ofertën e dorëzuar nga shoqëria jonë referuar një kriteri të pa kërkuar, duke e skualifikuar atë për mungesën e pretenduar të një shtojce e cila nuk është kërkuar në dokumentet e tenderit. Gjithashtu deklarata e pretenduar nuk luan asnjë rol në procesin e vlerësimit të ofertave pasi shoqëria jonë ka dorëzuar të gjithë deklaratat e kërkuara si edhe informacini i kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor gjendet i dorëzuar në tërësi në dokumentet e dorëzuara dhe autoriteti kontraktor smund të vlerësojë në mënyrë sipërfaqësore ofertat por duhet të shqyrtojë të gjithë dokumentacionin e dorëzuar dhe të vlerësojë në rast se mjetet/paisjet përmbushin minimumin e kërkesave të kërkuara nga ky i fundit. Gjithashtu, mjetet janë të disponueshme me anë të kontratës së qerasë dhe të shitjes me kusht me objekt të posaçëm procedurën konkrete të prokurimit. Ndaj dhe verifikimi është lehtësisht i lehtë pasi edhe deklarimi dhe disponueshmëria lidhen vetëm për këtë procedurë prokurimi. Në lidhje me pretendimin e dytë se kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirasë , nuk përcaktohet lloji i mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet gjykojmë se nuk është i bazuar në ligj dhe në fakt dhe si tillë nuk qëndron. Konkretisht në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar që "kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirase , nuk përcaktohet lloji i mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet. Së pari, sqarojmë se kontratat e mësipërme janë hartuar nga noter publik, funksionar publik i ngakruar nga ligji për noterinë dhe Kodi Civil për hartimin e kontratave të shitjes apo edhe të qerasë me ose pa kusht mes palëve dhe autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë vlerësosjë mbi ligjshmërinë e një kontrate të hartuar me vullnetin e lirë të palëve, përpara një noteri publik dhe mbi të gjitha në zbatim të neneve 757 dhe 801 e vijues të Kodit Civil. Së dyti në dokumentet e procedurës së prokurimit është kërkuar që nuk përcaktohet lloji i mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet, por nuk është përcaktuar se në cilin seksion të kontratës duhet të vendosen të dhënat e mësipërme, Kontrata dhe të gjithë anekset e saj janë një e vetme dhe duhet të interpretohen në tërësi dhe jo veçmas. Kontratat e mësnpërme jane lidhur para noterit publik ku në kushtet e kontratës janë përcaktuar qartësisht llojet e mjeteve dhe është dorëzuar dokumentacioni shoqërues me vulë bashkëlidhëse noterit pjesë e të njëjtit akt për të gjitha mjetet ku pasqyrohen të dhënat teknike të mjeteve objekt kontrate. Konkretisht në nenin 1 të kontratës së shitjes parashikohet se "Me lidhjen e kësaj kontrate, shitësi i shet blerësit mjetet e poshtëshënuara me dokumentacionin shoqërues të kësaj kontrate. E njëjta garanci jepet edhe në kontratën e qerasë ku parashikohet se "Qiradhënësi është pronar i ligjshëm i makinerive të mëposhtme të cilat vërtetohen nga lejet e qarkullimit bashkëngjitur). Në nenin



55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit ” Sa më sipër përsa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar se në cilën pjesë të kontratave duhen shprehur specifikimet teknike të mjeteve por është lënë në çmimin e operatoroëve ekonomikë atëherë kjo situatë është rregulluar nga noteri publik i cili ka përfshirë të gjithë dokumentacionin e kërkuar ku verifikohet lehtësisht përmbushja e specifikimeve teknike pjesë integrale të kontratave. Gjithashtu kontratat e mësipërme përmbajnë të gjithë të dhënat e kërkuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë ofertën e shoqërisë tonë referuar një kriteri të pa kërkuar. Referuar trajtimit të ankesë së shoqërisë tonë me anë të shkresës nr. 3127/1 protokollit datë 15.08.2018 konstatojmë se Komsioni i Shqynimit të Ankesave ka arsyetuar si më poshtë vijon : “Operatori ankimes ka paraqitur kontrata si me poshte : I-Kontrata shitje mjeteve me kusht Nr.1367 Rep , date 12.07.2018 midis shoqërisë “ Alkoimpex General Constraction” shpk dhe “Rej “ shpk dhe bashkangjitur janë dokumentat shoqëruar me mjeteve sipas lidhjes si me poshte :

-Mjeti me targa AA 633 PB ,APV,(automjet me perdorim te veçante) me kapacitet mbajtes 12.57 ton.

-Mjeti me targa AA634PB , APV,(automjet me perdorim te veçante) me kapacitet mbajtes 12.57 ton.

-Mjeti me targa AA631PB , APV ,(automjet me perdorim te veçante) me kapacitet mbajtes 5.8 ton.

-Mjeti me targa AA539TI ,APV, (automjet me perdorim te veçante) me kapacitet mbajtes 6.8 ton.

-Mjeti me targa AA344UB , ATP,(automjet per transport te perzejre),me kapacitet mbajtes 550 kg .

-Mjeti me targa AA538TI, ATP,(automjet per transport te perzejre), me kapacitet mbajtes 520 kg .

-Mjeti me targa AA589MS, me kapacitet mbajtes 3 ton, kamion

-Mjeti me targa AA618GM , ATP,(automjet per transport te perzejre), me kapacitet mbajtes 1.65 ton.

-Mjeti me targa AA675PI, , ATP,(automjet per transport te perzejre), me kapacitet mbajtes 1.41 ton .

-Mjeti me targa AA449OE , me kapacitet mbajtes 4.9 ton kamion vetshkarkues

-Mjeti me targa AA537TI , me kapacitet mbajtes 5.5 ton kamion vetshkarkues

-Mjeti me targa AGMT 47 ,fshesa mekanike.

-Mjeti me targa AA593MS , APV,(automjet me perdorim te veçante),me kapacitet mbajtes 8.97 ton.

-Mjeti me targa AA588MS, APV,(automjet me perdorim te veçante),bot uji me kapacitet 4000 litra.

KSHA gjate shqyrtimit te mjeteve te lidhur nga kontrata e mesiperme konstaton se palet kane bere nje kopjim te mjeteve qe ka kerkuar AK sipas se ciles ato do te jene object shitje me kusht ,por për te cilat nuk ka asnje percaktim apo ndarje te qarte se kush eshte mjet teknologjik dhe kush mjet transport kontenieresh e kush mjet veshkarkues e kush makine per larje rruges apo vaditje ne perputhje me specifikimet teknike per çdo mjet te cituara me siper. Ku shume qarte ne dst eshte percaktuar se ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/ Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve. Kontratat dhe marreveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbainë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.

II.Kontrata e qirase date 13.07.2018 midis Flamur Hoxhaj dhe “Rej” shpk nuk eshte e lidhur para noterit por ka te percaktuar llojin e mjetit (fadrome me goma) , tipin(JCB) dhe targon e tij(ACMT13) cope 1(nje) ashtu siç kerkohet ne DST nga Autoriteti Kontraktor

III.Kontrata e qirase Nr.1366 Rep , date 12.07.2018 midis shoqerise “ Ante Grup” dhe “ Rej” shpk dhe dokumentat shoqeruese te mjeteve si meposhte:

-Mjeti me targe AA147TJ ,APV (automjet me perdorim te veçante) kapacitet 10.4 ton ne pronesi Albanian Leasing.

-Mjeti me targe AA146TJ ,APV (automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 10.4 ton ne pronesi te Albanian Leasing

-Mjeti me targa AA312TM kapacitet 3.28 ton ne pronesi te Ante group ,kamion.

-Mjeti me tagra AA783OF me kapacitet 2.59 ton ne pronesi te Infnit Construction ,kamion.

-Mjeti me targa AA852TI , APV(automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 5.19 litra ne pronesi te Albanian Leasing.

-Mjeti me targa AA525TI , APV (automjet me perdorim te veçante) me kapacitet 8150 litra ne pronesi te Albanian Leasing date 28.03.2018 , siguruar nga Ante Group ne 29.01.2018 dhe nga ngjyre e verdhe ne dokumenta eshte e bardhe ne fakt.

Kontrata e qirasë Nr.1366 Rep , date 12.07.2018 midis shoqerise “ Ante Grup” dhe “ Rej” shpk se pari ka parregullsi ne formulimin e saj sepse: -Nuk kemi nje kontrate qeraje por nje kontrate nenqeraje; -ne kontrate percaktohet se : Qiradhenesi eshte pronar i ligjshem i makinerive te meposhteme te cilat vertetohen nga lejat e qarkullimit te secilit bashkangjitur kur ne fakt nuk jane ne pronesi te tij ( vetem nje mjet ) dhe jepen me qira mjete qe nuk jane ne pronesi te shoqerise “Ante group”,por qe kjo e fundit i ka marre me qera nga Albania LEASING sh.a .( MJETET APV). Gjithashtu KSHA konstaton se nuk kemi nje kontrate qeraje mes « ANTE-GRUP » dhe REJ SHPK por nje kontrate nenqeraje sepse kontrata e qerese eshte lidhur mes « ALBANIA LEASING » SHA dhe “Ante Grup” shpk ,date 05.04.2018. Gjithashtu KSHA referuar dates se lidhjes se kontrates se qerese mes “ Albania Leasing “ sh.a dhe « Ante Grup » shpk 05.04.2018 afatit te kontrates 5 vjet (60 muaj), Autorizimit te dhene nga Albania Leasing sha e cila autorizon “Ante Grup” shpk date 12.07.2018, qe ti jape me nenqera “Rej” shpk por qe afati e nenqerese nuk do te jete me i gjate se afati i qerese. Nga sa me siper kontrata e nenqerese per mjetet APV te cituara me siper nuk jane te vlefshme per te gjithë periudhen e e realizimit te kontrates objekt i ketij

prokurimi ( 5 vjet nga data e lidhjes se kontrates), siç kerkohet ne dokumentat e tenderit. Ashtu si theksuam me siper qe kontrata e nenqeresa do te jete sa ajo e qerese 5 vjet 60 muaj Data e kontrates se qerese eshte 05.04.2018 dhe perfundon ne date 05.04.2023, rrjedhimisht para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per kete objekt. Komisioni i shqyrtimit te Ankesave arsyeton se: 1.Operatori ankimues OE REJ shpk nuk ka paraqitur nje deklarate me shkrim per disponimin e mjeteve ku te specifikohet i detajuar lloji I mjetit, për se do përdoret , targa e tij , të dhënat teknike të mjeteve , me qira /në pronësi/apo lloj tjetër sipas kërkesave në dst dhe specifikimeve teknike pjesë e këtyre dokumentave. 2. Operatori “ REJ “ shpk deklaratën ku Autoriteti Kontraktor rezervon te drejtën të ktyejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e zyre nuk e ka te sakte se deklaroi qe mjetet ndodhen ne Xhafzotaj ne nje kohe qe i ka me kontrate shitje me kusht ose me qira . 3. Operatori “ REJ” shpk ka lidhur kontratë qeraje me Shoqerine ANTE-Grup jo te regullt. 4. Gjithashtu nga verifikimi i mjeteve te marra me qera dhe shitje me kusht te cituara me siper sipas ndarjes sonë rezulton se mungojnë : -Dy mjete teknologjik ( 5 ton) mjetet e paraqitura janë mbi 5 ton; -Dy mjete teknologjik e 1.5 -2 ton; - Mungon mjeti makine per larjen e rrugeve(autobot) te paisur me pompe per larjen e rrugeve me kapacitet 8000 litra; -Kontrata e qerese per mjetet: me targa AA852TI APV dhe AA525TI ,APV, perfundon para perfundimit te kontrates qe do te lidhet per realizimin e objektit. Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 ““Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës, kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtarit i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me

dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gëmia “ç” të Vendimit Nr.914 dt.29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se : [...]Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim I (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrlari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t'ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave. b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj. c) Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti kontraktor ta sigurojë këtë informacion. ç) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit [...]” Tashmë në vendimarrjen e konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik është mbajtur qëndrimi se KSHA dhe KPP nuk mund të ngrejë pretendime shtesë skualifikimi dhe konkretisht KPP 622/2016 KPP ka arsyetuar se:... **(citim vendimi KPP 622/2016)**

Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin 450/2017 ku është shprehur se:... **(citim vendimi KPP 450/2017)**

Megjithatë, sërish arsyetimi i mësipërm i autoritetit kontraktor është në kundërshtim me nenin 46 pika 1 dhe nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Në mënyrë të përmbledhur KSHA konstaton se me kontratën e “Ante Group” shpk kemi të bëjmë me një kontratë nënqeraje dhe jo një kontratë qeraje. Së pari, theksojmë se kontrata e nënqerasë është e njohur nga Kodi Civil dhe veçanërisht nga neni 819 i tij ku parashikohet se: “Qiramarrësi, veç marrëveshjes së kundërt, ka të drejtë të japë me nënqira sendin që ka marrë me qira, por nuk mund t'ia kalojë kontratën një tjetri pa pëlqimin e qiradhënësit. Për sende të luajtshme dhënia me nënqira bëhet me pëlqimin e qiradhënësit. ” Gjithashtu e drejta e nënqerasë së mjeteve objekt I kontratës së mësipërme parashikohet edhe nga neni 112 i kontratës bazë të qerasë financiare të lidhur mes “Ante-Group” shpk dhe “Albanian Leasing” sha ku parashikohet se transferimi i të drejtave bëhet me pëlqim të dy palëve. Në zbatim të dispozitave të nenit 819 të Kodit Civil dhe të kontratës së qerasë financiare (leasing) nr.826 rep dhe nr.590 kol datë 05.4.2018, para nëshkrimit të kontratës kemi dorëzuar para noterit publik, I cili ka verifikuar edhe plotësimin e kushteve ligjore edhe deklaratën nr.426 protokollit datë 12.07.2018 të qiradhënësit Albanian leasing, ku autorizon Ante Group shpk të japë me nënqira mjetet për operatorin ekonomik “Rej” shpk. Gjithashtu, kontrata e mësipërme është e lidhur para noterit publik dhe përmban të

*gjithë elementët e domosdoshëm të saj. Në aspektin formal juridik, kontratë e nënqarasë në drejtim të të drejtave dhe detyrimeve të palëve ofron të njëjtën trajtim me kontratën klasike të qerasë, edhe të njëjtat garanci për palët e treta. Autoriteti kontraktor, pretendon se kontrata e mësipërme e nënqarasë nuk është e vlefshme për gjatë gjithë periudhë së zbatimit të kontratës. Gjithashtu, edhe për pretendimin e mësipërm, gjykojme se ky i fundit nuk është i bazuar në fakt dhe në ligj. Për të mbështetur pretendimin e mësipërm, autoriteti kontraktor, tërësisht në interpretim të gabuar të ligjit ngre pretendimin se kontrata e qerasë financiare (bazë e lidhur mes Albanian Leasing sha dhe Ante Group shpk është për një kohëzgjatje prej 5 vitesh, si edhe autorizimi i Albanian Leasing sha nuk është më I gjatë se periudha e kontratës së qerasë. Në nenin 849 të Kodit Civil, nen i cili përshkruan edhe kontratën e qerasë financiare parashikohet se: “Me kontratën e qirasë financiare, njëra palë detyrohet të vërë në dispozicion të palës tjetër, për një kohë të caktuar, një send të luajtshëm ose të paluajtshëm, kundrejt një pagesë me afate periodike, të përcaktuar në lidhje me vleftën e sendit, me kohëzgjatjen e kontratës dhe, eventualisht me elemente të tjera sipas marrëveshjes së palëve. Sendi duhet të jetë fituar ose të jetë ndërtuar nga qiradhënësi sipas dëshirës dhe përshkrimit të qiramarrësit, dhe ky i fundit ka të drejtë të fitojë pronësinë, në mbarim të afatit të kontratës, kundrejt pagesës së një shume të paracaktuar”* Nënvizojmë se thelbi dhe dallimi thelbësor midis kontratës së qirasë financiare dhe kontratës klasike e normale të qerasë lidhet me faktin e në përfundim të kontratës së qerasë financiare qeramarrësi kundrejt pagimit të një çmimi të caktuar kthehet në pronar të sendit, konkretisht, mjeteve objekt i kontratës së nënqarasë. Referuar nenit 5 të kontratës së qerasë financiare (leasing) nr.826 rep dhe nr.590 kol datë 05.4.2018 parashikohet se çmimi i blerjes është 171,720 Euro ndërkohë që çmimi qerasë financiare është në vlerën 120,195.5 Euro. Pra, diferenca e mbetur është diferenca, sipas kushteve të kontratës, qiramarrësi i paguan qiradhënësit për të përfituar pronësinë përfundimtare të objektit të qirasë financiare. Gjithashtu, në nenin 10 të kontratës së mësipërme parashikohet se në përfundim të periudhës së leasing shoqëria “Ante Group” shpk në përputhje me detyrimet kontraktuale, përfiton pronësinë. Në kontratën nr.1366 repertori dhe nr.992 koleksioni datë 12.07.2018 parashikon se kontrata mes palëve është e vlefshme për një periudhë 6 vjeçare, lidhur me plotësimin me kushtit të fitimit të kontratës publike nga shoqëria “Rej” shpk. Sa më sipër, në përfundim të periudhës së leasing shoqëria “Ante Group” shpk shndërrohet për shkak të kontratës në pronar të ligjshëm të mjeteve dhe makinerive të mësipërme dhe njëkohësisht vijon edhe kontrata me shoqërinë “Rej” shpk pa cënuar asnjë garanci para Autoritetit kontraktor Bashkia Maliq. Së dyti, referuar deklarimeve të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, KSHA pretendon se deklarimi i adresës për kryerjen e verifikimeve nuk është i saktë në Xhafzotaj pasi kemi të bëjmë me kontratë qeraje dhe kontratë shitjeje me kusht. Sërish, aryeja e mësipërme është ngritur mbi pretendime a-priori dhe e pabazuar në fakte dhe prova. Shoqëria jonë, kishte marrë të gjithë masat në përputhje me shoqëritë e tjera që ka lidhur kontratë qiraje dhe shitje me kusht, që gjatë gjithë periudhës 20 ditore të shqyrtimit dhe vlerëimit të ofertave, mjetet kanë qenë të parkuara në adresën e deklaruar nga shoqëria jonë. Megjithë angazhimin tonë dhe lënien në dispozicion të një inxhinieri pranë mjeteve të parkuara në mjediset e deklaruar, sërish Komisioni i Vlerëimit të

Ofertave në përputhje me nenin 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar nuk mori asnjë masë për kryerjen e verifikimit fizik në rast të shfaqjes së nevojës për verifikime. Autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë në mënyrë hipotetike, por nëse ka patur dyshime mund të kryente verifikimet përkatëse. Gjithashtu, KSHA ka ngritur pretendimet se nuk ka asnjë përcaktim apo ndarje të qarte se kush është mjet teknologjik dhe kush mjet transport konteneresh e kush mjet vetshkarkues e kush makine për larje rrugesh apo vaditje në përputhje me specifikimet teknike për çdo mjet të cituara më sipër. Sërish, nënvizojmë se referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit nuk është përcaktuar një mënyrë e caktuar mbi mënyrën e hartimit të kontratës mes palëve. Megjithatë, referuar lejeve të qarkullimit, i vetmi dokument publik i lëshuar nga shteti shqiptar që vërteton mbi kapacitetin e mjetit, mund të merret lehtësisht informacioni i kërkuar. Në hipotezën se edhe ky informacion do të ishte i pamjaftueshëm, atëherë sërish në përputhje me nenin 66 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 « Për miratimin e rregullave të prokurimit publik » të ndryshuar, KVO ka patur në dispozicion ose të kërkojë sqarime mbi dokumentacionin e dorëzuar, ose të kryejë verifikime fizikisht në adresën e deklaruar. Asnjë prej dy mjeteve të mësipërme nuk është aplikuar. Në pjesën e fundit të pretendimeve të ngritura mbi mjetet, KSHA ka përshkruar të dhënat teknike të mjeteve, madje pretendon edhe mbi akte zyrtare të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor kur deklaroi se ngjyra e kamionit është e bardhë në fakt, ndërsa në letra është verdhë. Në kushtet e lajthitjes juridike ngre pretendimet se mjetet e deklaruar nga ana jonë nuk përmbushin specifikimet teknike dhe argumenton mbi kapacitetin mbajtës të mjeteve. Nënvizojmë se referuar Kriteretë të Veçanta të kualifikimit është përcaktuar se: Makine teknologjike (10 ton); Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike; (1.5-2 ton) Kamion vetshkarkues 3 -5 ton; Makine transportuese të kontenerëve; Makine teknologjike për fshirjen e rrugëve; Makine për larje rrugesh me kapacitet 8.000 litra ujë; Autobot uji për vaditje me kapacitet 4000 litra ujë. Sa më sipër, në asnjë gjërë të kriteretë të veçanta të kualifikimit nuk parashikohet kapacitet mbajtës i mjeteve por kapacitet i karrocërisë pa specifikuar në rast se kemi të bëjmë me kapacitet mbajtës apo kapacitet total të mjetit, duke e lënë në vlerëimin e operatorëve ekonomikë mbi përmbushjen e kriterit të mësipërm. Gjithashtu, konstatohet se nga ana e autoritetit kontraktor, referuar dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi është parashikuar një listë mjetesh dhe makinerish, dhe karakteristikat e karrocërisë së mjetit ( pa u përcaktuar nëse kemi të bëjmë me kapacitet mbajtës apo mjeti në total) dhe gjithashtu pa përcaktuar nëse kapaciteti i kërkuar nga autoriteti kontraktor është kapacitet minimal apo maksimal i lejuar. Në këtë mënyrë, duke qenë se vetë kriteri është i paqartë i drejtohemë parashikimeve të nenit 23 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 27 pika 1 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 23 të LPP dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara” Sa më sipër, duke qenë e kemi të bëjmë e specifikime teknike të mjeteve dhe paisjeve aplikohen dispozitat e mësipërme dhe

shoqëria jonë plotëson kapacitetin e kërkuar nga autoriteti kontraktor edhe minimumin e specifikimeve teknike të kërkuar nga ky i fundit për në tërësi mjetet dhe paisjet. Në të kundërt do të ndodheshim para vlerësimit të ofertës sonë referuar kritereve të pa kërkuara dhe që bie në kundërshtim me nenin 55 pika 2 të LPP-së. Në lidhje me plotësimin e kapacitetit mbi mjetet dhe paisjet të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe KPP në vendimin KPP 157/2017 ku ndër të tjera ka arsyetuar se: KPP konstaton se në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e mjeteve me karroceri vetëshkarkuese, ky i fundit (autoriteti kontraktor) ka përcaktuar vetëm elementin e karrocervisë së mjetit (vetëshkarkues) dhe kapacitet 1.5-3.5.ton, pa përcaktuar shprehimisht në rast se është kërkuar kapacitet total i mjetit ( masë maksimale e autorizuar) apo nëse është kërkuar kapacitet mbajtës i mjetit, duke lënë të hapur mbi mënyrën e plotësimit të kriterit të sipërcituar nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik. KPP gjykon se në asnjë rast referuar kritereve të veçanta të kualifikimit, autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar shprehimisht se kapaciteti i mësipërm të mjeteve të kërkuar është kapacitet mbajtës (kjo referuar edhe ndarjes së bërë në kërkimin mbi kapacitetit: mbi mjetet teknologjike, ku qartësisht është bërë dallimi mbi kapacitetin e kërkuar si kapacitet mbajtës i kompatitorit). KPP gjykon se në cilësinë e një organi quazi gjyqësor, në vendimarrjen e tij, ky i fundit i referohet parimeve të së drejtës Judicis est judicare secundum allegata et probata ( organi vendos në bazë të fakteve dite provave të administruara në proces) . KPP nuk mund të gjykojë mbi plotësimin e kritereve të veçanta të kualifikimit mbi kritere të cilat nuk janë parashikuar shprehimisht në dokumentet e garës. Sa më sipër arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.

Në përmbushje të kriterit të mësipërm, shoqëria "Rej" shpk ka dorëzuar: -Leje Kodi III.I.A e tipit "C " "Pastrim, larje sprucim ose veshje të mbetjeve të amballazheve, paketim, ose të kontenierëve në mënyrë që ë përdoren " me nr. PN-5796-09-2017; -Leje Kodi III.I.A e tipit "C " " Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme " me nr PN-2521-04-2016. Në nenin 46, pika 1 gërma "a" dhe "b" ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se : " [...]1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktori vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete të tjera fizike. aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm. për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;[...]"

Në nenin 28, pika 5, gërma "a" e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, përcaktohet: "Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a)

licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontrates, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose [...] Në seksionin Fusha III, “Kategoria III.1. “Për ndikimin në mjedis” , pika 1 dhe 2 gërma “a” të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr. 8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë ” 2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon: a) “Leje e thjeshte mjedisore ” me kodin III.1.A; b) “leje mjedisore ” me kodin III.1.3; c) “leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C. 3. Emërtimi në pikën 2.a zëvendëson emërtime “autorizim mjedisor” dhe “pëlqim mjedisor” që përdoren para fillimit të zbatimit të këtij vendimi sipas pikës 7 më poshtë. 4. Leja e nënkategorive A, B, C, trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkësës prej tij dhe afatet për tui përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën parë nga QKL, për nënkategoritë A, B, C janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Në shtojcën e ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se: - Fusha III Mjedisit dhe burime mjedisore bazë. –Leje për ndikimin në mjedis. Në nenin 29 të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT, parashikohet se: Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut: a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A; b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; c) kategoria e veprimtarive C, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C. Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit. Një rregullim i posaçëm në lidhje me lejet e mjedisit parashikohet nga Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, i ndryshuar” i cili në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se: Leje mjedisit e tipit A është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin I/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime. Në nenin 4 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit I ndryshuar” i cili në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se: Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë: a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji; Në nenin 8 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, I ndryshuar



parashikohet se: 1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji. 2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e me shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A, B apo C, sipas rastit. 3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk përgatit lejen e mjedisit të tipit A, kur provon mbi baza objektive se: a) pas zotërimit të asaj lejeje, kërkuesi nuk do të ëjetë operator i instalimit në fjalë; b) kërkuesi nuk do të sigurojë funksionimin e instalimit, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen në lejen përkatëse të mjedisit të tipit A. Për qëllime të këtij paragrafi, merret në konsideratë edhe historia e deriatëhershme e këtij kërkuesi të lejes dhe/ose historia e deriatëhershme e instalimit. Në ankesin 1 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, I ndryshuar” parashikohen edhe llojet e veprimtarive të cilat mund të licencohen...

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, si edhe nenit 46 pika 1 dhe nenit 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar në bazë të së cilës vendosen edhe kriteret e veçanta për kualifikim qëllimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor lidhet me vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë licencat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së kontratës së prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret autoriteti kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e licencës së fushës III kategori 1 nënkategoria “A”. Për një interpretim të saktë të kërkesës së autoritetit kontraktor si edhe kuadrin ligjor në fuqi në harmoni me të gjithë normat e tjera, vlerësojmë se duhet të drejtohem legjislacionit sektorial. Kështu, konkretisht ligji bazë nëpërmjet të cilit lëshohen edhe licencat dhe lejet në Republikën e Shqipërisë është ligji nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i cili në shtojcën e tij parashikon se Fusha III e lejeve përfshin lejeve kategoria 1 përfshin lejet për aktivitete të cilat kanë ndikim në mjedis. Gjithashtu edhe akti i dalë në zbatim të këtij ligji Vendimi nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përhashëkta, të ndryshuar në asnjë rast nuk parashikon një leje mjedisore e kategorisë III.1.A në përputhje me objektin e vendosur nga autoriteti kontraktor. Vetë VKM 53/2011 referon se kushtet e veçanta të nënkategorive të lejeve përcaktohen nga ligji nr. 10431, datë 9.6.2011 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT. Ky ligj parashikon detyrimin e paisjes me leje mjedisore të nënkategorisë A, B, C por duke referuar në zbatim të një ligji tjetër, siç është ligji nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, I ndryshuar”. Vetë ky

ligj në aneksin e tij nuk parashikon në asnjë rast se leja e fushës III.1 nënkategoria A jepet për një objekt specifik në fushën e menaxhimit të mbetjeve me përshkrim per pastrimin, larje rruges, fshirje rruges. Sa më sipër, licencimi në Republikën e Shqipërisë me leje të fushës III.1 nënkategoria A i nënshtrohet kuadrit ligjor sektorial në të cilin nuk parashikohet një leje specifike për këtë fushë me këtë përshkrim, të ndodhur në këto kushte, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe tashmë Komisioni i Prokurimit Publik duhet të shqyrtojë në rast se licencat/lejet e dorëzuara nga shoqëria “Rej” shpk përmbushin synimin e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor. Konkretisht, objekt i procedurës së prokurimit objekt ankimi është në fushën e menaxhimit të mbetjeve (referuar termave të ligjit për lejet mjedisore) dhe synimi i autoritetit kontraktor është të provojë se operatorët ekonomikë disponojnë leje mjedisore për per pastrimin, larje rruges, fshirje rruges. Shoqëria jonë ka dorëzuar në këtë procedurë prokurimi dy leje të lëshuara Leje Kodi III.1.A e tipit “C” “ Pastrim, larje sprucim ose veshje të mbetjeve të amballazheve, paketim, ose të kontenierëve në mënyrë që ë përdoren“ me nr. PN-5796-09-2017; Leje Kodi III.1.A e tipit “C ” “ Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme “ me nr. PN-2521-04-2016. Në interpretim gjuhësor të vetë Lejes së Kodi III.1.A e tipit “C” konstatojmë se kjo është lëshuar për: Pastrim, larj sprucim ose veshje të mbetjeve të amballazheve, paketim, ose të kontenierëve në mënyrë që ë përdoren ” me nr. PN-5796-09-2017, dhe presja në cilësinë ndarjes së gjymtyrëve të fjalisë, vecuese shtuese, duke parashikuar se objekti i veprimtarisë është për pastrim dhe larje dhe sprucim, duke u përfshirë në fushën e lejeve të menaxhimit të mbetjeve, larja, pastrimi dhe sprucimi lidhet me rrugët, sheshet, trotualet, VGM dhe çdo vend tjetër ku ushtrohet veprimtaria e menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu shoqëria disponon edhe licencim për stacion transferimi tëmbetjeve jo të rrezikshme që janë njëkohësisht edhe mbejtet urbane. Në nenin 20 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre. ” Në rastin konkret, autoriteti kontraktor po diskriminon shoqërinë tonë duke e skualifikuar për shkak të mungesës së nje licence e cila nuk ekziston ndërkohë që me anë të dokumentacionit të dorëzuar shoqëria jonë ka provuar se disponon të gjithë lejet dhe licencat e nevojshme të mundshme të lëshuara sipas legjislacionit në fuqi së pari dhe së dyti që përmbushin synimet e autoritetit kontraktor përçaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit. Gjithashtu kemi dyshime te bazuara se ne te njejtat kushte ndodhet edhe operatori ekonomik i kualifikuar. Gjithashtu nënvizojmë se në përzgjedhjen e fituesve të kontratave publike, autoritetet kontraktore janë të detyra të zbatojnë edhe 3 parimet kryesore të përcaktuara nga neni 2 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “ Përzgjedhja e fituesve të kontratave publike realizohet në përputhje me këto parime të përgjithshme: a) mosdiskriminim dhe trajtim i barabartë i ofertuesve ose kandidatëve, b) transparencë në procedurat e prokurimit; c) barazi në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve. Në rastin konkret asnjë nga tre parimet e mësipërme nuk janë zbatuar në vlerësimin e ofertave dhe përzgjedhjen e fituesit të kësaj kontrate publik. Nga verifikimi i kryer në regjistrin e lejeve dhe licencave edhe vetë operatori

ekonomik “Korsel” shpk nuk disponon leje mjedisore të kategorisë III.1.A me fushë veprimtarie per pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh por leja e tij është Pastrimi, grumbullimi transport dhe depozitim të mbetjeve të ngurta urbane e ndryshme nga kërkesa e autoritetit kontraktor. Pra, megjithëse edhe shoqëria “Korsel” shpk nuk disponon leje me përkshkrimin e autoritetit kontraktor ( pasi siç sqaruar edhe më lart, është një leje e cila nuk parashikohet dhe nuk lëshohet në përputhje me legjislacionin sektorial) autoriteti kontraktor ka diskriminuar shoqërinë tonë dhe nuk ka aplikuar parimin e barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve duke e kualifikuar këtë operator ekonomik dhe duke skualifikuar ofertën e shoqërisë tonë. Nën vizojmë se shoqëria jonë është e vetmja që disponon leje mjedisore sipas kërkesave të autoritetit kontraktor për ushtrimin e aktivitetit në Qarkun Korçë, pjesë e së cilës është edhe Bashkia Maliq në përputhje me ndarjen e re territoriale parashikuar nga ligji 115/2014. Ndërkohë operatori ekonomik i kualifikuar “Korsel” shpk, megjithëse ushron aktivitet në këtë territor, disponon leje mjedisore III.1.A për qarkun Vlorë, Bashkinë Sarandë dhe Ksamil. Lejet dhe Licencat e lëshuara në Republikën e Shqipërisë jepen për ushtrimin e aktivitetit në një territor të caktuar, kjo në përputhje me ligjin për lejet e mjedisit dhe për mbrojtjen e mjedisit. Vetë referuar akt miratimit të mësipërm konstatohet se vendi i kryerjes së aktivitetit është në qarkun Vlorë dhe nuk ka asnjë lidhje me Qarkun Korçë. Referuar trajtimin të ankesë së shoqërisë tonë me anë të shkresës nr. 3127/1 protokolli datë 15.08.2018 konstatohet se Komsioni i Shqyrtimit të Ankesave ka arsyetuar si më poshtë vijon : Lidhur me pretendimin e tretë: vërejmë se operatori ankimesh edhe në ankesën e tij i referohet legjislacionit vetëm përsa i përket menaxhimit të mbetjeve në stacionet e transferimit , ku edhe pika 5.6 pastrim , larje sprucim ose veshje e mbetjeve të amballazheve /paketimeve ose kontejnerëve në menyrë që të ripërdoren i korespondon pikërisht menaxhimit të mbetjeve në të gjitha instalimet. 1. Nga ana e Autoritetit Kontraktor është kërkuar : Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme). d. Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) per pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh . (Kodi III.1.A). e. Liçense e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) lidhur me ndikimin ne mjedis te lëshuar nga QKL.(Kodi III.2.A). f. Liçense e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim te mbetjeve urbane te lëshuar nga QKL.(Kodi III.2.B). Nga sa më sipër është përgjegjësi i OE të vërtetohet disponimin e këtyre lejeve mjedisore , Neni 34/4, i ligji Nr, 8934 date 05.09.2002 ” Per mbrojtjen e mjedisit ” thekson . Deklarata mjedisore, leja mjedisore, pëlqimi dhe autorizimi janë dokumente zyrtare që përcaktojnë kushtet dhe rrethanat në të cilat do të zhvillohet veprimtaria e miratuar për parandalimin dhe pakësimin e ndikimeve të saj në mjedis. Gjithashtu neni 23/ç i ligjit nr 10081 date 23.02.2009 “ Per licencat , autorizimet dhe lejat ne Republikën e Shqiperise parashikon se : leja lëshohet në bazë të formularëve të miratuar, që përbëjnë titullin e saj. Titulli përmban, të paktën, këto të dhëna llojin e veprimtarisë, veprimin apo të së mirës publike dhe të përdorimit të saj. Konkluzione : Ne rastin konkret OE nuk ka paraqitur Lejen mjedisore e lëshuar nga QKL per veprimtarine e kerkuar pastrimin larje rrugesh, fshirje rrugesh (kodi III.1.A).Në lidhje me trajtimin e mësipërm të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, së pari

konstatohet se nga ana e autoritetit kontraktor, KSHA nuk është dhënë asnjë argument i mbështetur në ligj mbi pretendimet e parashtruara nga shoqëria jonë. Referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor kemi parashtruar argumente ligjore mbi faktin se referuar legjilacionit sektorial në fuqi në asnjë nen nuk parashikohet mundësia e paisjes me QKL me objekt të posaçëm veprimtarie pastrim, larje e rrugës, fshirje rrugësh me kodin përkatës III.1.A. Referuar trajtimit të ankesës nga autoritetit kontraktor konstatohet se ky i fundit ka arsyetuar se : Nga sa me sipër është pergjegjesi i OE te vertetoje disponimin e ketyre lejeve mjedisore, Neni 34/4, i ligji Nr, 8934 date 05.09.2002 Per mbrojtjen e mjedisit thekson. Deklarata mjedisore, leja mjedisore pelqimi dhe autorizimi jane dokumente zyrtare qe percaktojne kushtet dhe rrethanat ne te cilat do te zhvillohet veprimtaria e miratuar, per parandalimin dhe pakesimin e ndikimeve te saj ne mjedis. Nënvizohet se, sërish ashtu si edhe në rastin e shqyrtimit dhe vlerësimit të kriterit mbi disponueshmërinë e mjekut, sërish kemi të bëjmë me lajthitje juridike të Shqyrtimit të Ankesave. Sërish, KSHA ka arsyetuar mbi një bazë ligjore të shfuqizuar, pasi referuar nenit 73 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” ligji nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe veçanërisht neni 34/4 është shfuqizuar. Gjithashtu pjesa tjetër e ligjit nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” është shfuqizuar edhe me anë të ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”. Akti mbi trajtimin e ankesës së shoqërisë tonë është një akt administrativ në kuptim të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative ” e për rrjedhojë akti i mësipërmë është një akt i paligjshëm në kuptim të nenit 109 gërma “d” si një akt i nxjerrë në kundërshtim me ligjin material (legjilacionin sektorial). Lejet e mësipërme të dorëzuar nga shoqëria jonë janë lëshuar në vitin 2017, ndërkohë që autoriteti kontraktor, ka vlerëunr dhe shqyrtuar ankesën e shoqërisë tonë referuar një ligji të shfuqizuar tërësisht në vitin 2013 ( 4 vite para lëshimit të lejeve). Autoriteti kontraktor në trajtimin e ankesës njëkohësisht ka arsyetuar se: “Gjithashtu neni 23/c; i ligjit nr 10081 date 23.02.2009 ”Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise parashikon se: leja leshohet ne baze te formulareve te miratuar, qe perbejne titullin e saj. Titulli permбан, te pakten, keto te dhena c) llojin e veprimtarise, veprimi apo te se mires publike dhe te perdorimit te saj» Sërish, autoriteti kontraktor ka dështuar të argumentojë dhe provojë se në përputhje me ligjin nr.10081/2009 parashikohet lëshimi i licencës në përputhje me objektin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Tashmë Komisioni i Prokurimit Publik ka konsoliduar praktikën e tij të gjykimit në lidhje me përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës duke konstatuar pas publikimit pavlefshmërinë e kriterëve. Ne vendimin e ngjashem KPP në vendimin 547/2017 ka vendosur se interpretimi mbi përmbushjen e nje kerkese ne ato raste kur parashikohet ndryshe ne ligj do te behet ne perputhje me frymen e kerkeses se autoritetit kontraktor dhe te parashikimit konkret te ligjit ne fuqi. Sa më sipër, arsyeja e skualifikimit nuk qëndron...

Në plotësim të kriterit të mësipërm të kualifikimit shoqëria jonë ka dorëzuar në këtë procedurë prokurimi: Kontratë pune lidhur me mjeken E.T, shoqëruar me CV, librezë pune, Diplomë dhe Licencë dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar.Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit,

duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”. Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” parashikohet shprehimisht se: 1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë çdo punëdhënës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve për të gjitha çështjet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë: a) ngarkon një ose disa punëmarrës, si persona përgjegjës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion; b) u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me ta. Kapitulli 11 “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet Për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcaktohet se: “1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon: 1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në: 1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit; b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në nënndarjen 1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”; c) industrinë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”. 1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë; b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve; c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët; ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”; d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike; dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale; e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike; ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve; f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit; g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit; gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike.

1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet: a) e industrisë bërthamore; b) me furrat koks; c) e përpunimit të naftës; ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë; d) e industrisë petro-kimike dhe karbokimike; dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi. 1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës: a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A; b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu,“ c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu; ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu. 1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B. 1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës. Per punëdhënësit që përfshihen në grupet A, B dhe C, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi kryhen gjithmonë nga personat e ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë. 3. Vetëm në rastet kur kapacitetet dhe burimet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për ta përmbushur këtë shërbim, ato bashkëpunojnë me persona apo shërbime të jashtme të specializuara për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese. 4. Për punëdhënësit e grupit D, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi, kryhen gjithmonë nga persona apo shërbime të specializuara jashtë ndërmarrjes, të kontraktuara nga punëdhënësi. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” , pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar: 1. ”Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A ” dhe “B” në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C ” dhe, D për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”. [...] 3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit”. 4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: “3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi”. Nga shqynimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit konstatojmë se autoriteti kontraktor ka arsyetuar mbi vendosjen e kriterëve të mësipërme me arsyetimin se: “Bazuar në Ligjin Nr.10237, date 18/02/2010 Per sigurine dhe shendetin ne pune”, i ndryshuar, neni 23 si dhe vendimin . Nr.312. date 05.05.2010 "Per miratimin e rregullores per sigurine ne kantier". aneksi V, VKM Nr.742 date 06.11.2003, duhet qe Operatori ekonomik te kete te

punesuar Mjekun e shoqërisë e vertetuar kjo me...." Në lidhje me bazën ligjore në fuqi, sqarojmë se: VKM nr. 742 date 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001 Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, gërma "b" dhe pika 4 gërma "b" thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi". Gjithashtu duke qenë se VKM nr. 742 date 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001 rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar duke qenë se akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Akti nënligjor në fuqi që rregullon detyrimin e subjekteve juridikë publikë dhe privatë për të punësuar mjek të shoqërisë, tashmë rregullohet nga Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë. Akti i mësipërm në fuqi Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë parashikon detyrimin e subjekteve juridikë për punësimin e mjekut të ndërmarrjes në raste të cilat nuk përfshihen në objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për një numër punonjësish duke nisur nga 750 e deri në 1000 punonjës sipas kategorisë dhe natyrës së veprimtarisë së shoqërisë, ndërkohë që referuar Shtojcës 7 "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit" "Kapaciteti Teknik", numri maksimal i punonjësve i kërkuar është 100 punonjës një numër shumë herë më i vogël se numri minimal i kërkuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit për disponueshmërinë e mjekut të ndërmarrjes. Referuar ligjit për prokurimin publik autoriteti kontraktor gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit miraton akte administrative duke nisur nga akti i miratimit të dokumenteve të tenderit. Kriteri i mësipërm i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është në përputhje me dispozitën e dhuruar ligjore e për rrjedhojë është i paligjshëm në kuptim të nenit 109 gërma "d" të Kodit të Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë. Në rastin konkret, shqyrtimi dhe vlerësimi i plotësimit të kriterit të mësipërm duhet të kryhet në dritën e ndryshimeve të fundit ligjore të cilat autoriteti kontraktor duhet ti kishte pasur parasysh në momentin e hartimit të kriterit të kualifikimit. Tashmë Komisioni i Prokurimit Publik ka konsoliduar praktikën e tij të gjyqimit në lidhje me përmbushjen e kriterëve të veçanta të kualifikimit në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në momentin e publikimit të Njoftimit të Kontratës duke konstatuar pas publikimit pavlefshmërinë e kriterëve. Në vendimin e ngjashëm KPP në vendimin 547/2017 ka vendosur se **(citim vendim KPP 547/2017...)**

Akoma më tej, ritheksojmë faktin se megjithëse baza e mësipërme ligjore e arsyetimit të vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është tashmë e shfuqizuar dhe nuk mund të ketë asnjë fuqi ligjore, pasi ndodhemi para rastit të shprehjes së vullnetit të organit të administratës publike me anë të një akti ligjor të shfuqizuar, sërish sqarojmë se edhe kriteri

*i kërkuar nga autoriteti kontraktor plotësohet nga ana e shoqërisë tonë pasi: Së pari, nënvizojë se pretendimi i autoritetit kontraktor se mjekja e shoqërisë tonë nuk figuron në listëpagesat e shoqërisë, nënvizojmë se ky pretendim nuk është i bazuar në fakt. Po të shqyrtohen me kujdes listëpagesat e shoqërisë mjekja figuron në listëpagesë për periudhën e kërkuar dhe nuk ka në asnjë moment shpëputje nga listëpagesat e shoqërisë tonë. Punonjësja mjekja E.T. vijon të jetë në listëpagesat e shoqërisë duke nisur nga muaji Janar 2017 e në vijim dhe pa asnjë shpëputje ( bashkëngjitur gjeni edhe listëpagesat e dorëzura në SPE). Referuar Kriteret e Veçanta të kualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar plotësimi i kriterit si më poshtë vijon; Te jete ne listepagesa per periudhen janar 2017-janar 2018. Në plotësim të kriterit të mësipërm, shoqëria jonë ka dorëzuar listëpagesat për periudhën e kërkuar, ku punonjësja E.T figuron në listëpagesa pa shpëputje. Vetë nga leximi i arsyes së skualifikimit, konstatojmë se autoriteti kontraktor e ka pranuar se mjekja figuron në listëpagesë kur shprehet se: Mjekja E. T. duke u bazuar ne listëpagesat, për periudhën Gusht 2017-Janar 2018 rezulton me leje lindje. Në asnjë fjali të kriterit të mësipërm nuk përcaktohet lloji i marrëdhënies të punës që duhet të ketë mjekja në listëpagesë, pra në rast se duhet të jetë me kohë të plotë në listëpagesë, me kohë të pjesshme apo e kontraktuar nga jashtë, apo nëse mund të jetë me shpëputje për arsye shëndetësore ose arsye të tjera të përligjura. Në rastin konkret autoriteti kontraktor po skualifikon ofertën e shoqërisë tonë referuar një kriteri të pa kërkuar, pasi në kriteret e veçanta të kualifikimit nuk përcaktohet lloji i marrëdhënies në listëpagesë, por autoriteti kontraktor ka përcaktuar vetëm që mjeku të jetë në listëpagesë. Kjo do të binte në kundërshtim me nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimit: publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. Punonjësja E.T disponon marrëdhënie pune me shoqërinë tonë, e rregulluar edhe nga Kodi i Punën. Konkretisht punonjësja figuron në listëpagesat e shoqërisë duke dëshmuar vijueshmëri të marrëdhënies së punës në përputhje me kriterin e veçantë të kualifikimit, por është me leje lindjeje. Neni 105 i Kodit të Punës parashikon se:*

- 1. Të ardhurat, që përfitohen në rast lejilindje, përcaktohen nga ligji mbi sigurimet shoqërore.*
- 2. Pas periudhës 63-ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore.*
- 3. Nëse gruaja vendos, me dëshirën e saj, të punojë pas periudhës 63 ditore të paslindjes, në marrëveshje me punëdhënësin, për ushqyerjen e fëmijës ka të drejtë që, deri sa fëmija të mbushë 1 vjeç, të zgjedhë: a) një pushim të paguar, prej 2 orësh, brenda kohëzgjatjes normale të punës; ose b) kohëzgjatje pune, të reduktuar me 2 orë, me pagë të njëjtë, sikur të kishte punuar për kohëzgjatjen normale ditore të punës.*
- 4. Me mbarimin e lejes së lindjes, punëmarrësi ka të drejtë të kthehet në vendin e punës ose në një vend pune të barasvlershëm, në kushte që nuk janë më pak të favorshme për të, si dhe të përfitojë çdo përmirësim të kushteve të punësimit që do të kishte pëdituar gjatë mungesë” Sa më sipër shoqëria jonë ka dëshmuar se disponon si pjesë të stafit të saj një mjek, për të gjithë periudhën e kërkuar, dhe të disponueshëm në momentin e dorëzimit të ofertave. Fakti se, në listëpagesat e shoqërisë “Rej” sh.p.k. mungon mjeku*



për muajt gusht 2017-janar 2018 nuk mund të penalizojë këtë operator ekonomik, ndërkohë që kjo mungesë ka ardhur për efekt të lejes së lindjes shkak ky i justifikuar dhe i lejuar nga Kodi i Punës, periudhë për të cilën nuk mund të paguhet nga shoqëria përkatëse. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur KPP në vendimin KPP 36/2017 për raste të ngjashme ku është shprehur se: **(citim vendim KPP 36/2017...)**

Referuar trajtimit të ankesë së shoqërisë tonë me anë të shkresës nr. 3127/1 protokolli datë 15.08.2018 konstatojmë se Komsioni i Shqyrtimit të Ankesave ka arsyetuar si më poshtë vijon : Pra edhe nga OE pranohet që ET për periudhën Gusht2017-Janar 2018 është me leje lindje dhe nuk është në punë. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Ndërsa në nenin 53, pika 3 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit... Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion, pasi ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme, si edhe përbën kusht për skualifikimin e tij nga procedura e prokurimit. Sqarojmë se, bazuar edhe në nenin 82 pika 1 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të RSH”, barra e provës për të vërtetuar plotësimin e kriterit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, bie mbi operatorin ekonomik, i cili në rastin konkret ka dështuar ta vërtetojë atë

Sërish konstatojmë e nga ana e autoritetit kontraktor përmendet termi i barrës së provës, në thelb pa njohur dhe kuptuar domethënien juridike të saj. Sërish, konstatojmë se nga ana e KSHA-së janë shtuar arsye skualifikimi, ku në rastin konkret arsyetohet se punonjësja nuk është në punë, ndërkohë që referuar arsyes së skualifikimit të njoftuar në app, kjo e fundit lidhet mbi faktin se punonjësja nuk është në listëpagesa. Nënvizojmë se janë dy arsye të ndryshme skualifikimi dhe se punonjësja figuron në listëpagesat e shoqërisë, por me kod të posaçëm me leje lindje e drejtë e njohur nga ligji në fuqi. Në lidhje me arsyen shtesë të ngritur se punonjësja nuk është në punë, nënvizojmë sërish se është jashtë tagrave të Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave vlerësimi në tërësi i dokumentacionit të dorëzuar në një procedurë prokurimi, pro vlerësimi lidhet ngushtësisht me arsyet e skualifikimit. Ashtu si trajtuam edhe në pjesë të tjera të kësaj ankese, nënvizojmë tashmë praktikën e konsoliduar të Komisionit të Prokurimit Publik në më shumë se 2 vendime mbi rastet e arsyeve shtesë të skualifikimit nga KSHA konkretisht, vendimit KPP 622/2016 dhe vendimit KPP 450/2017. Megjithatë, theksojmë se referuar kriterit të mësipërm, mbi disponueshmërinë e mjekut, në

asnjë rast nuk parashikohet lloji i marrëdhënies së punës, por vetëm fakti se mjeku të figurojë në listëpagesë. Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave referuar një kriteri të pa kërkuar përbën shkelje të nenit 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar ku parashikohet se: “Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit. ”Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka dështuar të provojë e baza e mësipërme ligjore mbi të cilin është vlerësuar edhe oferta jonë është fuqi, pasi kemi të bëjmë me një bazë ligjore të shfuqizuar. Sa më sipër arsyeja e skualifikimit nuk qëndron.[...]

II.8.Në datën 30.08.2018 autoriteti kontraktor me anë të shkresës nr.3246prot., datë 28.08.2018, ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e prokurimit të sipërcituar.

### III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe kërkesës të operatorit ekonomik ankimes,

#### Arsyeton:

III.1.Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “Në kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirasë , nuk përcaktohet lloji i mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet ”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1.Në pikën 2.3.11 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**1. Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

*Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:*

Nr.	Lloji i pajisjeve	Njësia	Sasia	Pronesi/Qera
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2	Pronesi/Qera
2	Makine teknologjike (5 ton)	copë	2	Pronesi/Qera
3	Makine teknologjike (1.5-2 ton)	Cope	2	Pronesi/Qera
4	Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton	copë	2	Pronesi/Qera
5	Makine transportuese të kontenierëve	Cope	1	Pronesi/Qera
6	Makinë teknologjike për fshirjen e	copë	1	Pronesi/Qera

	<i>rrugeve.</i>			
7	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
8	<i>Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi /Qera</i>
9	<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
10	<i>Makine per vijezim rruge me boje biokomponente</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>

*Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:*

- Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).*
- Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi).*
- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- Per mjetet me qera, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarinim e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.”*

III.1.2.Me anë të shtojcës datë 22.06.2018 “Shtojcë në dokumentet e tenderit“, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ngarkuar elektronikisht në SPE, autoriteti kontraktor ka kryer ndryshimet si më poshtë vijon:

**“-Ishte:**

### **3.2 Kapaciteti teknik:**

**11. Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës garanton që mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto (të qarta) për secilin mjet sipas listës së mëposhtme.*

Lista e makinerive qe duhet te disponoje operatori ekonomik te permbledhura ne tabelen e meposhtme:

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i pajisjeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2	Pronesi/Qera
2	Makine teknologjike (5 ton)	copë	2	Pronesi/Qera
3	Makine teknologjike (1.5-2 ton)	Cope	2	Pronesi/Qera
4	Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton	copë	2	Pronesi/Qera
5	Makine transportuese te konteniereve	Cope	1	Pronesi/Qera
6	Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.	copë	1	Pronesi/Qera
7	Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje	copë	1	Pronesi/Qera
8	Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje	cope	1	Pronesi /Qera
9	Fadrome me goma	copë	1	Pronesi/Qera
10	Makine per vijezim rruge me boje biokomponente	copë	1	Pronesi/Qera

Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:

- Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).
- Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi).
- Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).
- Per mjetet me qera, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.

**Bëhet:**

### **3.2 Kapaciteti teknik:**

**11. Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës garanton që mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.**
- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto (të qarta) për secilin mjet sipas listës së mëposhtme.**

*Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:*

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i pajisjeve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2
2	Makine teknologjike (5 ton)	copë	2
3	Makine teknologjike (1.5-2 ton)	Cope	2
4	Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton	copë	2
5	Makine transportuese të konteniereve	Cope	1
6	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugeve.	copë	1
7	Makine për për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje	copë	1
8	Autobot uji për vaditje me kapacitet 4000 litra uje	cope	1
9	Fadrome me goma	copë	1
10	Makine për vijezim rruge me boje biokomponente	copë	1

*Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqiten dokumentacioni si më poshtë:*

- *Mjetet në pronësi shoqerohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).*
- *Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerave të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve ( e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).*
- *Ne rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve.*

**Kontratat dhe marrëveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.**

- *Per mjetet që shihen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumenti që verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Per mjetet me qera, me Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve , duhet të paraqiten*

*dokumenti qe verteton regjistrimin certifikaten e kontrollit teknik siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”*

III.1.3.Në shtojcën, pikat 1.5, 4.5, 5.5 “Specifikime teknike“, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ngarkuar elektronikisht në SPE, autoriteti kontraktor ka përcaktuar, si më poshtë vijon:

*“1.5 Mjetet dhe pajisjet*

*Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, (mbledhjes, transportit, largimit të mbeturinave) dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:*

*Makina e nevojshme teknologjike për grumbullimin dhe transportin e mbeturinave urbane si dhe shërbimeve mbështetëse, të kërkuara për realizimin e kontratës, janë të renditura si më poshtë:*

*Mjetet e parashikuara*

*a.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me pak se 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak se 2 (dy) copë;*

*b.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2 (dy) copë;*

*c. b.Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo me shume se 1.5-2 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, jo më pak 2 (dy) copë;*

*d. Kamion vetshkarkues ,te hapur nga sipër me hapje te spondit anesor ose nga pas te paisur me mbulesë ,per grumbullimin dhe transportin e mbetjeve te vëllimshme dhe te ndertimit me kapacitet 3-5 ton 1 (nje)*

*d.Fadrom me goma cope 1(nje)*

*Makinat teknologjike që do përdoret për shërbimin e transportit te mbetjeve urbane duhet të jenë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.*

*4.5 Mjetet dhe pajisjet*

*Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion për plotësimin e detyrave kontraktuale të fshirjes me makineri të rrugëve si dhe të gjitha Shërbimeve Plotësuese të përcaktuara më lart, këto mjete dhe pajisje:*

a.Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, e pajisur me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore , sistem thithës të pluhrave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, 1 (një) copë; Makina teknologjike që do përdoret për shërbimin e fshirjes duhet të jetë në përputhje me të dhënat teknike dhe specifike të mjeteve sipas ofertës dhe në përputhje me këtë kontratë si dhe dhe të jetë konform normave teknike të Komunitetit European.

#### 5.5 Mjetet dhe pajisjet për larjen e rrugëve

Operatori i shërbimit duhet të sigurojë për realizimin e larjes me presion të rrugëve sipas përcaktimeve të kontratës, të gjitha punimet, materialet, pajisjet si dhe lejet përkatëse. Operatori i shërbimit duhet të vërë në dispozicion dhe të përdorë për plotësimin e detyrave kontraktuale të larjes së rrugëve këto mjete:

a.Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtjes jo më pak se 8000 litra ujë, 1(nje) copë;

Makina për larjen e rrugëve që do të përdoret nga operatori i shërbimit për plotësimin e detyrimeve kontraktuale, mund të kontrollohet në çdo kohë nga Autoriteti kontraktor për gjëndjen e gadishmërisë.

b. Makina për larjen e rrugëve duhet të mbahen në gjendje të pastër dhe të mirë,

c.Një sasi e konsiderueshme e pjesëve të ndërrimit duhet të mbahen gati për të siguruar plotësimin në kohë dhe të vazhdueshëm të kontratës.

Autoriteti Kontraktor ka parashikuar dhe vijezim rruge me boje Biokomponente per te cilen kerkohet qe Operatori Ekonomik duhet te kete ne dispozicion nje makineri per realizimin e ketij sherbimi. ”

III.1.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterëve të sipërcituar, operatori ekonomik ankimues, “Rej” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

1. Kontratë shitje mjetesh me kusht nr.1367rep., nr.993kol., datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “AlkoImpex General Construction” sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e blerësit, me objekt: “Me lidhjen e kësaj kontrate, Shitësi i shet Blerësit mjetet e poshtëshënuara (me dokumentacion shoqërues kësaj kontrate) kundrejt pagesës nga ana e Blerësit të cmimit të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate. Mjete do jenë të lira, nga cdo barrë, detyrime, pengje, kufizime apo pretendime nga palë të treta. Mjetet objekt shitblerje do të jenë si më poshtë:

Nr.	Të dhënat e tipit të mjeteve dhe të dhënat teknike të mjeteve	Njësia	Sasia
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2
2	Makine teknologjike (5 ton)	copë	2
3	Makine teknologjike (1.5-2 ton)	Cope	2
4	Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton	copë	4

5	<i>Makine transportuese te konteniereve</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>
6	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
7	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
8	<i>Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>

*Palët bien dakort se që shitja kushtëzohet nga realizimi i kushtit të poshtëshënuar : - Blerësi shpallet fitues i procedurës së prokurimit “Shërbime të Pastrimit dhe Gjelbërimit” organizuar nga bashkia Maliq”*

2. Dokumentacion bashkëlidhur kontratës së mësipërme: Leje Qarkullimi, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse për mjetet si vijon: -Mjeti me targë AA 633 PB, APV; - Mjeti me targë AA634PB, APV; -Mjeti me targë AA631PB, APV; -Mjeti me targë AA539TI, APV; -Mjeti me targë AA344UB, ATP; -Mjeti me targë AA538TI, ATP; -Mjeti me targë AA589MS, kamion; -Mjeti me targë AA618GM, ATP; -Mjeti me targë AA675PI, ATP; -Mjeti me targë AA449OE, kamion vetëshkarkues; -Mjeti me targë AA537TI, kamion vetëshkarkues; -Mjeti me targë AGMT 47, fshesa mekanike; -Mjeti me targë AA593MS, APV; -Mjeti me targë AA588MS, APV, bot uji.
3. Kontratë qiraje me kusht nr.1366rep., nr.992kol., datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Ante-Group” sh.p.k në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit, me objekt: *“Qiradhënësi është pronar i ligjshëm i makinerive të mëposhtme të cilat vërtetohen nga Lejet e Qarkullimit të secilit (bashkëlidhur)*

<i>Nr.</i>	<i>Të dhënat e tipit të mjeteve dhe të dhënat teknike të mjeteve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>
<i>1</i>	<i>Makine teknologjike (10 ton)</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>2</i>	<i>Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>
<i>3</i>	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>
<i>4</i>	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>

4. Dokumentacion bashkëlidhur kontratës së mësipërme: Leje Qarkullimi, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse për mjetet si vijon: -Mjeti me targë AA147TJ, APV; -Mjeti me targë AA146TJ, APV; -Mjeti me targë AA312TM, kamion; -Mjeti me tagrë AA783OF, kamion; -Mjeti me targë AA852TI, APV; -Mjeti me targë AA525TI, APV;
5. Deklaratë zhdoganimi për mjetin fadromë.
6. Kontratë qiraje me kusht datë 13.07.2018, lidhur ndërmjet z. F. H. në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënie me qira me kusht të fadromës me goma me targë ACMT13 (JCB), shoqëruar me Leje Qarkullimi, Certifikatë pronësie mjeti rrugor, Policë për sigurimin e



detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse.

III.1.5. Në nenin 46, pika 1 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”* Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.6. Neni 28, pika 5, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *5.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a)licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b)një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla;dhe/ose c)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. d)“Në rastin e procedurës së prokurimit “Shërbim konsulence”, stafi i angazhuar të paraqesë deklaratë disponueshërie për kryerjen e shërbimeve që ka marrë përsipër të realizojë”*

III.1.7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht, me qëllim përmbushjen e kriterit të sipërcituar lidhur me disponimin e mjeteve “*Makine teknologjike (10 ton); Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike (1.5-2 ton); Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton; Makine transportuese të konteniereve; Makinë teknologjike për fshirjen e rrugeve; Makine për për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje; Autobot uji për vaditje me kapacitet 4000 litra uje*”, KPP vëren se, operatori ekonomik ankimes, ka paraqitur Kontratë shitje mjetesh me kusht nr.1367rep., nr.993kol., datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “AlkoImpex General Construction” sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e blerësit, shoqëruar me dokumentacionin Leje Qarkullimi, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse për mjetet si vijon: -Mjeti me targë AA147TJ, APV; -Mjeti me targë AA146TJ, APV; -Mjeti me targë AA312TM, kamion; -Mjeti me tagrë AA783OF, kamion; -Mjeti me targë AA852TI, APV; -Mjeti me targë AA525TI, APV. Nga shqyrtimi i kontratës të shitjes me kusht të sipërcituar, rezulton se në asnjë nen të saj nuk janë pasqyruar të dhënat identifikuese të mjeteve objekt kontrate (targë/nr. shasie, markë, model etj), si dhe nuk janë pasqyruar të dhëna teknike të mjeteve sipas përcaktime të autoritetit kontraktor në kriterin e vendosur në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, ndryshuar

me shtojcën e cituar në pikën III.1.2. të këtij vendimi. Referuar nenit 705 e në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Komisioni gjykon se kontrata e shitjes të një sendi, të luajtshëm apo të paluajtshëm, lidhet ndërmjet palëve me qëllim shprehjen e vullnetit të tyre në mënyrë të dokumentuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi, mbi kalimin e pronësisë të sendit nga pala shitëse te pala blerëse kundrejt një vlere të caktuar nga vetë palët. Kontrata e shitjes, përvec të tjerave, parashikon të drejtat dhe detyrimet e palëve lidhur me kalimin e pronësisë dhe trajtimin e sendit në rastet kur dorëzimi i tij nga shitësi te blerësi, apo pagesa e vlerës të caktuar në kontratë, nuk bëhen menjëherë me nënshkrimin e kontratës. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për të përmbushur detyrimet mbi sendin të përcaktuara në kontratë nga palët si dhe të drejtat e palëve mbi të, është tepër i nevojshëm identifikimi i sendit konkretë në kontratën e shitjes, duke përcaktuar të dhëna identifikuese si numër serie apo markë, targë apo numër shasie, ngjyrë, karakteristika teknike (rasti i mjeteve mototrike), për të shmangur ndërrimin e sendit me një send tjetër me të dhëna teknike të tjera me ato të dakordsuara nga palët, dëmtimin e tij etj., sidomos në rastin konkretë të kontratës të shitjes me kusht në të cilën sendi nuk është në posedim të blerësit. Vlen të theksohet se, detyrimet kontraktore me efekt të menjëhershëm apo të mëvonshëm, parashikohen në nenet e kontratës dhe jo në dokumentacionin bashkëlidhur saj, dokumentacion i cili nuk shërben për të identifikuar sendin apo për te sanksionuar detyrim kontraktor, por shërben për të vërtetuar pronësinë e palës shitëse mbi sendin.

Nga ana tjetër, kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor është në sinkron me parashikimet e nenit 6 të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 “*Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore*”, në të cilin përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një kontratë shitblerje mjeteve motorrike: “*Neni 6 Kontrata noteriale, Në formulimin e një kontrate noteriale, duhet të konsiderohen për përmbajtje dhe përshkrim këto elemente: 1. Gjeneralitetet e plota të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit; 2. Adresat e vendbanimit të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit; 3. Të dhënat teknike të mjetit, si: targa, numri i identifikimit, lloji, marka, emërtimi tregtar, ngjyra; 4. Numri i serisë së lejes së qarkullimit dhe certifikatës së pronësisë vetëm kur mjete është i regjistruar në DPSHTRR; 5. Përgjegjësitë ligjore dhe administrative; 6. Detyrimet financiare ndaj DPSHTRR-së*”. Në këto kushte, Komisioni gjykon se kontrata e shitjes së mjeteve me kusht nr.1367rep., nr.993kol., datë 12.07.2018, e paraqitur nga ankimuesi për të vërtetuar disponueshmërinë e mjeteve të kërkuara nga autoriteti kontraktor për zbatimin e kontratës, “*Makine teknologjike (10 ton); Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike (1.5-2 ton); Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton; Makine transportuese te konteniereve; Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve; Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje; Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje*”, nuk është sipas kërkesave të autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit dhe në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 “*Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore*”.

III.1.8. Nga verifikimi i dokumentave të tjera të paraqitura nga ankimuesi në përmbushje të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me disponimin e mjeteve, Komisioni konstaton se me anë të tyre, edhe në hipotezën se ky dokumentacion do të ishte sipas

kërkesave të autoriteti kontraktor, nuk vërtetohet disponueshmëria me një nga mënyrat ligjore për mjetet, *Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike (1.5-2 ton); Makine transportuese te konteniereve; Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje*, të kërkuara në dokumentat e tenderit, të ndryshuara me shtojcën përkatëse. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Përsa më sipër, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.11 të shtojcës 8, "Kapaciteti teknik", në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën datë 22.06.2018 "Shtojcë në dokumentet e tenderit".

III.1.9. K.P.P. gjykon se kuadri ligjor parashikon një sërë elementësh si garanci për operatorët ekonomikë të cilët kanë paqartësi në lidhje me interpretimin e kërkesave të autoritetit kontraktor dhe/ose mënyrës së plotësimit të kriterëve kualifikuese. Në rast se operatori ekonomik ankimues do të kishte paqartësi në lidhje mbi plotësimin e kërkesës së mësipërme, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së kërkesës për sqarime pranë autoritetit kontraktor deri në pesë ditë para dorëzimit të ofertave parashikuar nga neni 42 i LPP-së. Në nenin 42, pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, parashikohet se "[...] *Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit [...]*".

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2.Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Rej" sh.p.k. për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron pasi operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriterin e veçantë të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të K.P.P. mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i

pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, me shumicë votash,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit*”, me nr. REF-55053-03-09-2018, me fond limit 139,642,150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1416 protokoli Datë 20.08.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

## MENDIM KUNDËR

Mendim kundër i anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik znj. Lindita Skeja (Anëtar) dhe znj. Vilma Zhupaj (Anëtar), në lidhje me vendimin e shumicës.

Si anëtarë të KPP shprehim mendimin kundër arsytimit të vendimit e rrjedhimisht dhe të dispozitivit të tij, për sa i përket ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Rej” sh.p.k., konkretisht nuk jemi dakord me arsyetimet në pikat III.1, III.2., për sa i përket çështjes me Objekt: Shfuqizimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k., në procedurën e prokurimit, “*Procedurë e Hapur*”, me objekt, “*Shërbime të pastrimit dhe gjelbërimit*”, me nr. REF-55053-03-09-2018, me fond limit 139,642,150 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.07.2018, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Maliq.

Pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

### Arsyetojmë:

I.1. Para shqyrtimit të të gjithë arsyeve të skualifikimit të ofertës së operatorit ekonomik “Rej” shpk, fillimisht, gjykojmë të ndalemi në arsyetimin e shumicës në lidhje me arsyen e skualifikimit mbi kontratën e shitjes së mjeteve.


I.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Rej” sh.p.k. mbi skualifikimin e ofertës së tij, në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen : “*Në kontratën e shitjes me kusht por edhe në kontratën e qirasë, nuk përcaktohet lloji i mjetit dhe të dhënat teknike të tyre ashtu siç kërkohet*”, vërejmë se:

I.3. Në pikën 2.3.11 të shtojcës 8, “Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

**2. Kandididati/operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

*Lista e makinerive që duhet të disponoje operatori ekonomik të përmbledhura në tabelen e mëposhtme:*

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i pajisjeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>1</i>	<i>Makine teknologjike (10 ton)</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>2</i>	<i>Makine teknologjike (5 ton)</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>3</i>	<i>Makine teknologjike (1.5-2 ton)</i>	<i>Cope</i>	<i>2</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>4</i>	<i>Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton</i>	<i>copë</i>	<i>2</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>5</i>	<i>Makine transportuese te konteniereve</i>	<i>Cope</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>6</i>	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>7</i>	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>8</i>	<i>Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje</i>	<i>cope</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi /Qera</i>
<i>9</i>	<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
<i>10</i>	<i>Makine per vijezim rruge me boje biokomponente</i>	<i>copë</i>	<i>1</i>	<i>Pronesi/Qera</i>



*Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:*

- *Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie origjinal ose kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).*
- *Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (origjinal ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi).*
- *Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Per mjetet me qera, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.”*

I.4. Me anë të shtojcës datë 22.06.2018 “Shtojcë në dokumentet e tenderit“, të procedurës së prokurimit objekt ankimi, të ngarkuar elektronikisht në SPE, autoriteti kontraktor ka kryer ndryshimet si më poshtë vijon:

“-*Ishte:*

### **3.2 Kapaciteti teknik:**

**11. Kandidati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës garanton që mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto (të qarta) për secilin mjet sipas listës së mëposhtme.*

*Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:*

<i>Nr.</i>	<i>Lloji i pajisjeve</i>	<i>Njësia</i>	<i>Sasia</i>	<i>Pronesi/Qera</i>
1	<i>Makine teknologjike (10 ton)</i>	<i>copë</i>	2	<i>Pronesi/Qera</i>
2	<i>Makine teknologjike (5 ton)</i>	<i>copë</i>	2	<i>Pronesi/Qera</i>
3	<i>Makine teknologjike (1.5-2 ton)</i>	<i>Cope</i>	2	<i>Pronesi/Qera</i>
4	<i>Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton</i>	<i>copë</i>	2	<i>Pronesi/Qera</i>
5	<i>Makine transportuese te konteniereve</i>	<i>Cope</i>	1	<i>Pronesi/Qera</i>
6	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	1	<i>Pronesi/Qera</i>
7	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	1	<i>Pronesi/Qera</i>
8	<i>Autobot uji per vadije me kapacitet 4000 litra uje</i>	<i>cope</i>	1	<i>Pronesi /Qera</i>
9	<i>Fadrome me goma</i>	<i>copë</i>	1	<i>Pronesi/Qera</i>
10	<i>Makine per vijezim rruge me boje biokomponente</i>	<i>copë</i>	1	<i>Pronesi/Qera</i>



*Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqitet dokumentacioni si më poshtë:*

- *Mjetet ne pronesi shoqerohen me akt pronesie original ose kopje te noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).*
- *Mjetet me qira shoqerohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronesise se qiradhenesit (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerese te permbaje objektin dhe afatin e marrjes me qera te mjeteve ( e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi).*
- *Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Per mjetet me qera, duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin e tij plus certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerese/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre.*

**Bëhet:**

### **3.2 Kapaciteti teknik:**

**11. Kandididati/ operatori ekonomik duhet të paraqesë kapacitetet e mëposhtme teknike që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:**

- ***Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Deklaratë me anë të së cilës garanton që mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.***

- **Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto (të qarta) për secilin mjet sipas listës së mëposhtme.**

Lista e makinerive që duhet të disponojë operatori ekonomik të përmbledhura në tabelën e mëposhtme:

<b>Nr.</b>	<b>Lloji i pajisjeve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2
2	Makine teknologjike (5 ton)	copë	2
3	Makine teknologjike (1.5-2 ton)	Cope	2
4	Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton	copë	2
5	Makine transportuese të konteniereve	Cope	1
6	Makinë teknologjike për fshirjen e rrugeve.	copë	1
7	Makine për për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje	copë	1
8	Autobot uji për vaditje me kapacitet 4000 litra uje	cope	1
9	Fadrome me goma	copë	1
10	Makine për vijezim rruge me boje biokomponente	copë	1

*Shënim: Për Makineritë dhe Mjetet teknologjike të kërkuara më sipër, duhet të paraqiten dokumentacioni si më poshtë:*

- *Mjetet në pronësi shoqërohen me akt pronësie origjinal ose kopje të noterizuar (kontrata shitblerje ose kontrata dhurimi).*
- *Mjetet me qira shoqërohen me kontrate qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhenesit (origjinal ose kopje të noterizuar). Kontrata e qerave të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve ( e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi).*
- *Në rast se mjetet nuk janë në pronësi apo me qera mund të paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marrëveshje për shitjen me kusht të mjeteve.*

**Kontratat dhe marrëveshjet e sipërcituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj.**

- *Per mjetet qe shenohen ne regjistra publike duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin si leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme).*
- *Per mjetet me qera, me Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve , duhet te paraqitet dokumenti qe verteton regjistrimin certifikaten e kontrollit teknik siguracionin e mjetit,(te vlefshme) duhet te shoqerohet me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e çdoganimit ose faturat tatimore te blerjes.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”*

I.5. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike në përmbushje të kriterëve të sipërcituar, operatori ekonomik ankimes, “Rej” sh.p.k, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

7. Kontratë shitje mjetesh me kusht nr.1367rep. , nr.993kol. , datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “AlkoImpex General Construction” sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e blerësit, me objekt: *“Me lidhjen e kësaj kontrate, Shitësi i shet Blerësit mjetet e poshtëshënuara (me dokumentacion shoqëruar kësaj kontrate) kundrejt pagesës nga ana e Blerësit të cmimit të përcaktuar në nenin 2 të kësaj kontrate. Mjete do jenë të lira, nga cdo barrë, detyrime, pengje, kufizime apo pretendime nga palë të treta. Mjetet objekt shitblerje do të jenë si më poshtë:*

Nr.	Të dhënat e tipit të mjeteve dhe të dhënat teknike të mjeteve	Njësia	Sasia
1	Makine teknologjike (10 ton)	copë	2

2	<i>Makine teknologjike (5 ton)</i>	<i>copë</i>	2
3	<i>Makine teknologjike (1.5-2 ton)</i>	<i>Cope</i>	2
4	<i>Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton</i>	<i>copë</i>	4
5	<i>Makine transportuese te konteniereve</i>	<i>Cope</i>	1
6	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	1
7	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	1
8	<i>Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje</i>	<i>cope</i>	1

*Palët bien dakort se që shitja kushtëzohet nga realizimi i kushtit të poshtëshënuar : -Blerësi shpallet fitues i procedurës së prokurimit “Shërbime të Pastrimit dhe Gjelbërimit” organizuar nga bashkia Maliq”*

8. Dokumentacion bashkëlidhur kontratës së mësipërme: Leje Qarkullimi, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse për mjetet si vijon: -Mjeti me targë AA 633 PB, APV; - Mjeti me targë AA634PB, APV; -Mjeti me targë AA631PB, APV; -Mjeti me targë AA539TI, APV; -Mjeti me targë AA344UB, ATP; -Mjeti me targë AA538TI, ATP; -Mjeti me targë AA589MS, kamion; -Mjeti me targë AA618GM, ATP; -Mjeti me targë AA675PI, ATP; -Mjeti me targë AA449OE, kamion vetëshkarkues; -Mjeti me targë AA537TI, kamion vetëshkarkues; -Mjeti me targë AGMT 47, fshesa mekanike; -Mjeti me targë AA593MS, APV; -Mjeti me targë AA588MS, APV, bot uji.
9. Kontratë qiraje me kusht nr.1366 rep , nr.992kol., datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “Ante-Group” sh.p.k në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit, me objekt: *“Qiradhënësi është pronar i ligjshëm i makinerive të mëposhtme të cilat vërtetohen nga Lejet e Qarkullimit të secilit (bashkëlidhur) .*

<b>Nr.</b>	<b>Të dhënat e tipit të mjeteve dhe të dhënat teknike të mjeteve</b>	<b>Njësia</b>	<b>Sasia</b>
1	<i>Makine teknologjike (10 ton)</i>	<i>copë</i>	2
2	<i>Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton</i>	<i>copë</i>	2
3	<i>Makinë teknologjike per fshirjen e rrugeve.</i>	<i>copë</i>	1
4	<i>Makine per për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje</i>	<i>copë</i>	1

10. Dokumentacion bashkëlidhur kontratës së mësipërme: Leje Qarkullimi, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse për mjetet si vijon: -Mjeti me targë AA147TJ, APV; -Mjeti me targë AA146TJ, APV; -Mjeti me targë AA312TM, kamion; -Mjeti me tagrë AA783OF, kamion; -Mjeti me targë AA852TI, APV; -Mjeti me targë AA525TI, APV;

11. Deklaratë zhdoganimi për mjetin fadromë.

12. Kontratë qiraje me kusht datë 13.07.2018, lidhur ndërmjet z. F. H. në cilësinë e qiradhënësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënie me qira me kusht të fadromës me goma me targë ACMT13 (JCB), shoqëruar me Leje Qarkullimi, Certifikatë pronësie mjeti rrugor, Policë për sigurimin e detyrueshëm të mbajtësve të mjeteve motorrike për përgjegjësinë ndaj palëve të treta, Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore, lëshuar nga SGS, si dhe fotografitë përkatëse.

I.6. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

I.7. Në nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

I.8. Në nenin 28 “Kontrata e Shërbimeve” pika 5 gërma “ç” të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

**I.9. Referuar arsytimit të vendimit nga shumica e anëtarëve, konstatojmë se këto të fundit kanë shqyrtuar në themel vlefshmërinë e aktit notarial Kontratë shitje mjetesh me kusht nr.1367rep., nr.993kol., datë 12.07.2018, lidhur ndërmjet shoqërisë “AlkoImpex General Construction” sh.p.k në cilësinë e shitësit dhe shoqërisë “Rej” sh.p.k në cilësinë e blerësit. Ndër të tjera, shumica ka arsyetuar se : « Nga ana tjetër, kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor është në sinkron me parashikimet e nenit 6 të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 “Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore”, në të cilin përcaktohen elementët që duhet të përmbajë një kontratë shitblerje mjetesh motorrike: “Neni 6 Kontrata noteriale, Në formulimin e një kontrate noteriale, duhet të konsiderohen për përmbajtje dhe përshkrim këto elemente: 1. Gjeneralitetet e plota të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit; 2. Adresat e vendbanimit të personave në cilësinë e shitësit dhe blerësit; 3. Të dhënat teknike të mjetit, si: targa, numri i identifikimit, lloji, marka, emërtimi tregtar, ngjyra; 4. Numri i serisë së lejes së qarkullimit dhe certifikatës së pronësisë vetëm kur mjete është i regjistruar në DPSHTRR; 5. Përgjegjësitë ligjore dhe administrative; 6. Detyrimet financiare ndaj DPSHTRR-së”. Në këto kushte, Komisioni gjykon se kontrata e shitjes së mjeteve me kusht nr.1367rep., nr.993kol., datë 12.07.2018, e paraqitur nga ankimuesi për të vërtetuar disponueshmërinë e mjeteve të kërkuara nga autoritetit kontraktor për zbatimin e kontratës, “Makine teknologjike (10 ton); Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike (1.5-2 ton); Kamion vetëshkarkuese 3-5 ton; Makine transportuese të kontenerëve; Makinë teknologjike për fshirjen e rrugeve; Makine për për larje rrugësh me kapacitet 8.000 litra uje; Autobot uji për vaditje me kapacitet 4000 litra uje”, nuk është sipas kërkesave të autoritetit kontraktor në dokumentat e tenderit dhe në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 “Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore”**

Në lidhje me arsyetimin e mësipërm vlerësojmë se nga ana e shumicës së anëtarëve të Komisionit nuk është marrë në konsideratë baza ligjore si më poshtë vijon:

**Në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se:**

1. Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

a) Kushtetuta; b) marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara; c) ligjet; ç) aktet normative të Këshillit të Ministrave.

2. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juridiksionit territorial që ushtrojnë këto organe.

3. Aktet normative të ministrave dhe të organeve drejtuese të institucioneve të tjera qendrore kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë brenda sferës së juridiksionit të tyre.

**Nenet 705 e vijues të K.Civil**

Ligj nr.7829, datë 1.9.1994 “Për noterinë”, i ndryshuar,

- Neni 40 Aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike. Gjatë redaktimit të një akti ose kryerjes së një veprimi noterial noteri u bën të qartë palëve kërkesat e ligjit për rastin konkret dhe, brenda kufijve të tij, ruan si interesat e palëve, ashtu edhe ato të të tretëve.
- Neni 41 Noteri refuzon redaktimin e çdo akti, përmbajtja e të cilit bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit. Refuzimi bëhet me vendim të arsyetuar të noterit dhe i njoftohet të interesuarit brenda pesë ditëve nga dita e paraqitjes së kërkesës për redaktimin e aktit. Personat që kanë kërkuar redaktimin e aktit ose që janë drejtpërdrejt të interesuar, brenda pesë ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi, mund të ankohen në gjykatën e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës vepron zyera noteriale, e cila brenda pesë ditëve nga paraqitja e ankesës vendos rreth çështjes.
- Neni 68P avlefshmëria e aktit ose e veprimit noterial mund të kërkohet nga personat që kanë marrë pjesë në hartimin e tij dhe nga çdo person që heq të drejta e merr përsipër detyrime prej tyre. Kërkesa shqyrtohet nga gjykata e rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale.
- Neni 69 Në vendimin e gjykatës që deklaron të pavlefshëm një akt noterial, urdhërohet zyra përkatëse e noterisë të bëjë shënimet e duhura në origjinalin e aktit, i cili ndodhet i depozituar në këtë zyrë.

Në nenin 1 të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 “Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore”, parashikohet se: “Qëllimi i këtij udhëzimi është të krijojë kuadrin e nevojshëm normativ për përcaktimin e procedurave, kompetencave, kriterëve dhe dokumentacionit për ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore dhe përditësimin e lejes së qarkullimit të tyre, në mënyrë që të garantohet evidentimi i saktë i pronësisë mbi këto mjet”

I.10. Në lidhje me vlefshmërinë e aktit notarial dhe në rast se ky i fundit përmbush të gjithë elementët e kërkuar nga ligji, vlerësojmë se kontrata e mësipërme e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues për të dëshmuar përmbushjen e kriterit në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve dhe paisjeve për realizimin me sukses të kontratës është kryer me anë të një veprimi notarial, kontratë shitje me kusht hartuar para një noteri publik në Republikën e Shqipërisë.

Nënvizojmë se kontrata e mësipërme noteriale për shitjen e pasurisë së paluajtshme është kontratë me kusht e për rrjedhojë **regjistrimi i mjeteve në regjistrat publikë nga ana palës blerëse në vijim do të kryhet vetëm në rast të plotësimit të kushtit, pra, pas shpalljes fitues të palës blerëse në rastin konkret operatorin ekonomik ankimues “Rej”**

**shpk.** Nënvizojmë se shumica e anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik ka shqyrtuar vlefshmërinë e kontratës noteriale duke qënë se pari në kundërshtim me hierarkinë e akteve ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Në lidhje me këtë çështje, nënvizojmë se në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dispozitë e cila sqaron edhe piramidën hierarkike të akteve ligjore në fuqi, sqaron se në rradhë të parë është Kushtetuta, pasuar nga Marrëveshjet Ndërkombëtare dhe më pas ligjet.

**Së pari, vlefshmëria e akteve ligjore të dala në zbatim të ligjit kontrata e shitjes me kusht e miratuar në zbatim të Kodi Civil- ligj i miratuar me ¾ e votave të Parlamentit), nuk mund të shqyrtohet dhe më pas vlerësohet bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrave.** Në nenin 1 të Udhëzimit të Përbashkët Nr. 232, Datë 14.1.2016 *“Mbi ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore”*, parashikohet se: *“Qëllimi i këtij udhëzimi është të krijojë kuadrin e nevojshëm normativ për përcaktimin e procedurave, kompetencave, kritereve dhe dokumentacionit për ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore dhe përditësimin e lejes së qarkullimit të tyre, në mënyrë që të garantohet evidentimi i saktë i pronësisë mbi këto mjete”*.

Sa më sipër, nënvizojmë se Udhëzimi ka si objekt për përcaktimin e procedurave, kompetencave, kritereve dhe dokumentacionit për ndryshimin e pronësisë së mjeteve rrugore dhe përditësimin e lejes së qarkullimit të tyre, në mënyrë që të garantohet evidentimi i saktë i pronësisë mbi këto mjete, ndërkohë që kontrata e shitjes me kusht të mjeteve nuk i nënshtrohet dispozitave të mësipërme, pasi procesi i regjistrimit i përket një momenti të dytë *ex post* pas plotësimit të kushtit pezullues të kontratës, pra vetëm në rast të shpalljes fitues të palës blerëse.

Së dyti, kontrata e mësipërme është hartuar në bazë të nenit 41 të Ligj nr. 7829, datë 1.9.1994 *“Për noterinë”*, i ndryshuar, i cili parashikon se: *“Noteri refuzon redaktimin e çdo akti, përmbajtja e të cilit bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit”*. Në rastin konkret, noteri nuk ka kundërshtuar redaktimin e aktit, por e ka hartuar dhe nënshkruar atë pasi ky i fundit nuk bie në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit. Theksojmë se një ndër parimet kryesore të së drejtës është ai se (prej faktit rrjedh e drejta), pra noteri publik ka vërtetuar faktin se kontrata e mësipërme dhe mënyra e formimit të sajë shtë në përputhje me ligjin ndaj ka lindur e drejta e redaktimit dhe hartimit të aktit notarial, kontratë shitje me kusht.

Së treti, shumica e anëtarëve ka tejkaluar kompetencat duke vlerësuar edhe vlefshmërinë e kontratës noteriale, ku bazuar në nenin 68 të ligjit për noterinë është kompetencë e gjykatës së rrethit gjyqësor, në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale.

Së katërti, vendimi i mësipërm është në kundërshtim edhe me praktikën e ndjekur nga organi administrative, Komisioni i Prokurimit Publik, ku në raste *mutatis mutandis*, po Komisioni i Prokurimit Publik, përbërë nga anëtarë pjesë të vendimit të shumicës në



rastin konkret kanë vlerësuar se KPP nuk mund të vlerësojë mbi vlefshmërinë e akteve ligjore. Kjo bie ndesh edhe me parimin e vendosur në Kodin e Procedurave Administrative, mbi qëndrueshmërinë në vendimarrje të organit administrati ku konkretisht në nenin 101 gërma “d” të të cilit parashikohet se: “organi nxjerr një akt administrativ në vijim të praktikës së ndjekur për zgjidhjen e çështjeve objektivisht të njëjta.”

**KPP në vendimin 450/2017 *Inter alia dhe mutatis mutandis* është shprehur se: ....**

*Në nenin 40 të ligjit Nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar, parashikohet se “Aktet noteriale të hartuara në pajtim me ligjin, kanë fuqinë e akteve autentike. Gjatë redaktimit të një akti ose kryerjes së një veprimi noterial noteri u bën të qartë palëve kërkesat e ligjit për rastin konkret dhe, brenda kufijve të tij, ruan si interesat e palëve, ashtu edhe ato të të tretëve.”. Nga interpretimi literal i nenit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se aktet noteriale të hartuara sipas parashikimeve të ligjit Nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar, kanë të njëjtën fuqi me aktet origjinale, për sa kohë nuk është deklaruar i pavlefshëm nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor në territorin e së cilës e ushtron veprimtarinë zyra noteriale që ka kryer këto akte a veprime noteriale, sipas parashikimeve të neneve 68 dhe 69 të ligjit Nr.7829, datë 1.6.1994 “Për Noterinë”, i ndryshuar. KPP gjykon se një dokument i deklaruar autentik nëpërmjet nënshkrimit dhe vulosjes nga noteri sipas ligjislacionit në fuqi, nuk ka nevojë të shoqërohet domosdoshmërisht nga dokumenti origjinal për të vërtetuar origjinalitetin e aktit noterial.*

**Së pesti, konstatojmë se KPP ka shqyrtuar pretendimin e ankimuesit bazuar në hipoteza, ku ndër të tjera deklaroi se: “Komisioni konstaton se me anë të tyre, edhe në hipotezën se ky dokumentacion do të ishte sipas kërkesave të autoriteti kontraktor, nuk vërtetohet disponueshmëria me një nga mënyrat ligjore për mjetet, Makine teknologjike (5 ton); Makine teknologjike (1.5-2 ton); Makine transportuese te konteniereve; Autobot uji per vaditje me kapacitet 4000 litra uje, të kërkuara në dokumentat e tenderit, të ndryshuara me shtojcën përkatëse. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Gjithashtu, kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit. Përsa më sipër, operatori ekonomik ankimues nuk e përmbush kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor në pikën 2.3.11 të shtojcës 8,**

“Kapaciteti teknik”, në dokumentat standarte të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, ndryshuar me shtojcën datë 22.06.2018 “Shtojcë në dokumentet e tenderit”.

**Në thelb pretendimet e mësipërme janë ngritur nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në tejkallim të kompetencave dhënë nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenin 78 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Ndaj, gjykojmë se KPP nuk mund të tejkalojë tagrat e tij duke marrë në hipotezë pretendime shtesë të cilat nuk janë pasqyruar në raportin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.**

Gjykojmë se, referuar kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi përaftimin e llojit dhe mjeteve të marra me qera ose në forma të tjera të disponueshmërisë lidhet me faktin e verifikimit të përmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit mbi kapacitetin teknik të mjeteve të kërkuara nga ana e autoritetit kontraktor. Pasi morën në shqyrtim kontratat për të cilat janë ngritur pretendime nga ana e autoritetit kontraktor konstaton se kontratat e mësipërme janë noteriale, hartuar para noterit dhe se pjesë integrale të tyre janë edhe dokumentacioni teknik i mjeteve (leje qarkullimi, etj) në të cilën pasqyrohen të dhënat teknike të mjeteve. Gjykojmë se megjithëse në kriteret e veçanta të kualifikimit është përcaktuar se në kontratat e qirave/shitjes duhet të përcaktohen të dhënat teknike të mjeteve në asnjë rast nuk përcaktohet në cilën pjesë të kontratës apo në ankeset e saj duhet të parashikohet. Gjykojmë se me anë të dokumentacionit të dorëzuar, operatori ekonomik ankimues provon në lidhje me specifikimet teknike të mjeteve të kërkuara të cilat janë lehtësisht të verifikueshme nga ana e autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor nuk mund të shqyrtojë në mënyrë sipërfaqësore, por të marrë në shqyrtim në themel pretendimet ankimuesit.

**Kontrata/t e mësipërme të dorëzuara nga ankimuesi përmbajnë të gjithë elementët formal të nevojshëm dhe të parashikuar nga ligji në fuqi dhe mbi të gjitha janë hartuar para noterit publik i cili i nënshtrohet ligjit dhe Kushtetutës dhe në asnjë rast nuk mund të hartojë akte në kundërshtim me to. Nga ana tjetër në kuadër të pjesëmarrjes në një procedurë prokurimi, autoriteti kontraktor nuk mund të skualifikojë ofertën e operatorit ekonomik ankimues me pretendimin se kontrata e mësipërme nuk mund të regjistrohet për efekt të ndërrimit të pronësië duke u ngritur mbi hipotezë dhe në një moment *ex post* pas lidhjes së kontratës, i paraparë si kusht pezullues në kontratën e shitjes. Gjithashtu, autoriteti kontraktor ka të gjithë instrumentat ligjorë të monitorimit të zbatimit të kontratës.**

Në lidhje me pjesën e dytë të arsyes së skualifikimit konstatojmë se referuar arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues nga ana e autoritetit kontraktor janë ngritur pretendime në lidhje me mos dorëzimin e deklaratës mbi disponueshmërinë e mjeteve si edhe me faktin se në kontratat e dorëzuara (të shitjes/qerasë) nuk përcaktohen të dhënat teknike të mjeteve. Nga shqyrtimi në tërësi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt ankimi, kriterëve të veçanta të kualifikimit si edhe shtojcave të dokumenteve të kësaj

procedure, konstaton se nga ana e autoritetit kontraktor nuk është parashikuar në asnjë rast dorëzimi i një deklarate specifike mbi disponueshmërinë e mjeteve për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Referuar kritereve të veçanta të kualifikimit konstatojmë se nga ana e autoritetit kontraktor në lidhje me disponueshmërinë e mjeteve është kërkuar dorëzimi i deklaratave si më poshtë vijon: - *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së kryerjes së shërbimit. -Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe të beje deklarinimin e adreses së sakte të vendodhjes së mjeteve me qëllim verifikimin e tyre. »*

Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elekktronike, konstatojmë se nga ana e operatorit ekonomik ankimes, përveç deklaratës mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, si pjesë e shtojcës në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt ankimi janë dorëzuar edhe deklaratat i. Deklaratë *Mbi verifikimin e mjeteve* me përmbajtje si mëposhtë vijon: *DEKLARATE PER MJETET E operatorit ekonomik pjesëmarrës në Procedurën e Prokurimit Publik, që do të zhvillohet në datë 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt “Sherbime të Pastrimit dhe Gjelberimit” me fond limit 139.642.150 ( Njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) lek pa TVSH Une i nënshkruari LUAN KAPRI me cilesinë e ADMINISTRATORIT të operatorit ekonomik “REJ” sh.p.k deklaroi se Autoriteti Kontraktor Rezervon të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa lajmërim paraprak. Adresa e mjeteve me qëllim verifikimin e tyre është në selinë kryesore të Operatorit ekonomik REJ sh.p.k: Xhafzotaj Durres ii.Deklaratë se mjetet nuk janë angazhuar në kontrata të tjera me përmbajtje si më poshtë vijon: E operatorit ekonomik pjesëmarrës në Procedurën e Prokurimit Publik, që do të zhvillohet në datë 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt “Sherbime të Pastrimit dhe Gjelberimit” me fond limit 139.642.150 (Njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë) lek pa TVSH Une i nënshkruari LUAN KAPRI me cilesinë e ADMINISTRATORIT të operatorit ekonomik “REJ” sh.p.k deklaroi dhe garantoj se mjetet teknologjike nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera iii. Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike të mjeteve me përmbajtje si më poshtë vijon: E operatorit ekonomik pjesëmarrës në Procedurën e Prokurimit Publik, që do të zhvillohet në datë 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt “Sherbime të Pastrimit dhe Gjelberimit” me fond limit 139.642.150 (Njëqind e tridhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e dyzetë e dy mijë e njëqind e pesëdhjetë)lek pa TVSH Une i nënshkruari LUAN KAPRI me cilesinë e ADMINISTRATORIT të operatorit ekonomik “REJ” sh.p.k deklaroi se mjetet e paraqitura janë në përputhje me specifikimet teknike pjesë përbërëse e këtyre dokumenta tenderi.iv.Deklaratë mbi disponueshmërinë e mjeteve si më poshtë vijon:E operatorit ekonomik pjesëmarrës në Procedurën e Prokurimit Publik, që do të zhvillohet në*

date 17.07.2018 nga Autoriteti Kontraktor BASHKIA MALIQ me objekt "Sherbime te Pastrimit dhe Gjelberimit" me fond limit 139.642.150 ( Njeqind e tridhjte e nente milion e gjashteqind e dyzete e dy mije e njeqind e pesedhjte ) lek pa TVSH Une i nenshkruari LUAN KAPRI me cilesine e ADMINISTRATORIT te operatorit ekonomik "REJ" sh.p.k deklaroj se mjetet do te jene te disponueshme gjate gjithe periudhes se kryerjes se sherbimit. »

Sa më sipër gjykojmë se nga ana e operatorit ekonomik ankimues janë dorëzuar të gjithë deklaratat e kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor, ndërkohë për deklaratën mbi disponueshmërinë e mjeteve KPP gjykon se kjo e fundit nuk është pjesë as e shtojcave të dokumenteve të procedurës së prokurimit si edhe as në kriteret e veçanta të kualifikimit. Në nenin 55 pika 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin public" të ndryshuar parashikohet se: "Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit."

Sa më sipër, gjykojmë se në rastin konkret autoriteti kontraktor nuk mund të gjykojë dhe vlerësojë ofertën e një operatori ekonomik referuar kriterëve të pa kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit.

#### **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

II. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues "Rej" shpk për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se "1 - Ka mangësi në plotësimin e kriterit për kontratat e ngjashme te realizuara ne tre vitet e fundit .Operatori ekonomik "Rej" sh.p.k. për të vërtetuar se ka kryer eksperiencia te mepareshme te ngjashme gjate tre viteve të fundit, ka paraqitur dy kontrata, njera me ish Komunen Udenisht dhe tjetra është lidhur me Bashkinë Pogradec ndërmjet bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k., Ne te cilën nuk ka asnjë të dhënë në lidhje me përqindjen që ka secili prej anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë "Rej" sh.p.k. & "Shpresa" sh.p.k., në mënyrë që të perlllogaritet pjesa e sherbimeve te kryera nga shoqëria "Rej" sh.p.k. e që rrjedhimisht të verifikohet nëse e përmbush kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit. - Kontrata e lidhur me Bashkinë Pogradec date 16.01.2016 ka te percaktuar se si operator ekonomik është bashkimi i shoqërive "Rej" sh.p.k. dhe "Shpresa" sh.p.k., dhe si e tillë duhet që të vërtetohet sa është pjesa e përqindjes së marrë përsipër prej secilit prej ketyre anetareve, ndërkohë që edhe në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Pogradec Nr.4634/1 prot. , date 26.06.2018 nuk jepet asnjë e dhënë në lidhje me këtë përqindje, por thuhet se kjo kontrate eshte e realizuar me sukses dhe i vetëm nga shoqëria "Rej" sh.p.k. (ne kundërshtim me LPP dhe VKM Nr. 914 te ndryshuar neni 74, pika 2, Bashkimi I Operatoreve ekonomike,) edhe pse në kontratën e lidhur eshte percaktuar qarte qe kjo kontratë lidhet me bashkimin e operatorëve ekonomikë dhe jo vetëm me shoqërinë "Rej" sh.p.k. vërejmë se:

II.1. Në shtojcën mbi modifikimin e dokumenteve të tenderit, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

### **3.3 Kapaciteti teknik:**

#### **1. Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:**

- a. Shërbime të një natyre të ngjashme me objektin e prokurimit me vlerë **jo më të vogël** se 40% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe konkretisht: **55.856.860** (pesedhjetë e pese milion e teteqind e pesedhjetë e gjashtë mijë e teteqind e gjashtedhjetë) **Lekë pa TVSH**, të kryera gjatë tri viteve të fundit.

*Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:*

- a. Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me institucione shtetërore, Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur :
  - Kontratën e nënshkruar me institucionin,
  - Vertetim per relizimin e kontrates me sukses.
- b. Kur shërbimi i një natyre të ngjashme është realizuar me subjekte private, Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë shërbim duke paraqitur faturat tatimore perkatese të shitjes (ku te shprehen qarte datat,shumat dhe shërbimet e realizuara).

II.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Rej” shpk ka dorëzuar:

- Kontratë datë 16.01.2015 lidhur mes bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk & “Shpresa” shpk të përfaqësuar nga shoqëria “Rej” shpk dhe autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec me objekt kontrate “Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit”

-Vërtetim nr.4634/1 protokollit datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec me përmbajtje “Në përgjigje të kërkesës suaj me lëndë “Kërkesë për vërtetim realizimi me sukses” nr.4634 datë 26.06.2018 konfirmojmë se: Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, më datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit në qytetin e Pogradecit, **në bazë të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Vlera e realizuar e këtij shërbimi për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore. Kjo kontratë është përmbushur me sukses nga operatori ekonomik “Rej” shpk.**

- Kontrate lidhur me Komuna Udenisht.

II.3. Në nenin 46 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e

mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, **përvojën e duhur**, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

Në nenin 53 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.”

Në nenin 28 “Kontrata e Shërbimeve” pika 3 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti kontraktor kërkon dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tri viteve të fundit. Në çdo rast, vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit. Autoriteti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose/dhe faturave tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Në nenin 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “5. Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.”

II.4. Gjykojmë se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët

ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta, duhet të refuzohen si të papranueshme.

II.5. Në rastin konkret, konstatojmë se pretendimi i autoritetit kontraktor lidhet mbi plotësimin e dëshmisë së eksperiencës së ngjashme, referuar kritereve të veçanta të kualifikimit. Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, konstatojmë se operatori ekonomik ankimues “Rej” shpk në përmbushje të kritereve të veçanta të kualifikimit, ka dorëzuar kontratë datë 16.01.2015 lidhur mes bashkimit të përkohshëm të operatorëve ekonomikë “Rej” shpk & “Shpresa” shpk të përfaqësuar nga shoqëria “Rej” shpk dhe autoritetit kontraktor Bashkia Pogradec me objekt kontrate “Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit” Gjithashtu, operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar edhe Vërtetimin nr.4634/1 protokollin datë 26.06.2018 lëshuar nga autoriteti kontraktor Bashkia Pogradec me përmbajtje “Në përgjigje të kërkesës suaj me lëndë “Kërkesë për vërtetim realizimi me sukses” nr.4634 datë 26.06.2018 konfirmojmë se: *Në zbatim të kontratës së sipërmarrjes, më datë 16 Janar 2015, shërbimi i pastrimit në qytetin e Pogradecit, në bazë të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është realizuar me sukses dhe i vetëm nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Vlera e realizuar e këtij shërbimi për periudhën 17 Janar 2015-31 Maj 2018 është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore. Kjo kontratë është përmbushur me sukses nga operatori ekonomik “Rej” shpk. Në nenin 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet se: “5.Në rast falimentimi të përfaqësuesit të bashkimit të operatorëve ekonomikë ose në rrethana të tjera, që ndërpresin veprimtarinë e tij gjatë zbatimit të kontratës, autoriteti kontraktor mund të vazhdojë kontratën me një operator tjetër ekonomik, anëtar të bashkimit, me kusht që ai të zotërojë kapacitetet ligjore, ekonomike, financiare dhe teknike për të zbatuar kontratën. Përndryshe, autoriteti kontraktor zgjidh kontratën. Në rast se këto rrethana i ndodhin operatorit tjetër ekonomik, atëherë detyrimet e operatorit të dështuar ekonomik mund të merren përsipër nga përfaqësuesi ose nga një anëtar tjetër i bashkimit, me kusht që ky të plotësojë kërkesat.”*

Konstatojmë se, megjithëse kontrata e dorëzuar si dëshmi për eksperiencë të ngjashme nga ana e operatorit ekonomik ankimues është lidhur mes dy anëtarëve të bashkimit të operatorëve ekonomikë të shpallur fitues në procedurën përkatëse të zhvilluar nga Bashkia Pogradec, referuar po Vërtetimin nr.4634/1 protokollin datë 26.06.2018 të lëshuar nga Bashkia Pogradec kontrata është zbatuar tërësisht nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë, shoqëria “Rej” shpk. Në lidhje me zbatimin e kontratës në mënyrë të vetme nga operatori ekonomik “Rej” shpk, gjejmë se në rastin konkret, referuar edhe vërtetimit të lëshuar nga Bashkia Pogradec në cilësinë e institucionit që ka zhvilluar procedurën e

prokurimit si edhe ka lidhur kontratën për të cilën janë ngritur edhe pretendime nga autoriteti kontraktor në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.6. Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga operatori ekonomik ankimues, konkretisht shkresës nr.5917/1 prot datë 06.08.2018, Bashkia Pogradec ndër të tjera ka argumentuar se “*Në datën 16.01.2015 është lidhur kontrata e shërbimit me objekt “Pastrim, grumbullim dhe largim i mbeturinave publike të qytetit të Pogradecit”.* Kontrata është lidhur me shoqëritë “Rej” shpk dhe “Shpresa” shpk, përfaqësuar nga shoqëria “Rej” shpk. Në lidhje me kërkesën tuaj mbi përqindjen e kryerjes së shërbimit dhe zbatimit të kontratës nga secili operator ekonomik, ju informojmë se duke nisur nga data 17.01.2015 e në vijim, kontrata është realizuar e plotë në të gjithë vlerën e deklaruar të saj prej 107,687,190 lekë pa TVSH **vetëm nga shoqëria “REJ” shpk me NUIS J93711608Q.** Shërbimi i pastrimit të qytetit të Pogradecit është kryer në përputhje me kushtet e kontratës dhe detyrimet janë marrë përsipër vetëm nga shoqëria “Rej” shpk në zbatim të parashikimeve ligjore, kushteve dhe rrethanave të përcaktuara nga neni 74 pika 5 e Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Në lidhje me vlerën totale të shërbimit, sqarojmë se për periudhën 17 Janar 2015- 31 Maj 2018, vlera e shërbimit të ofruar është 105,047,372 (Njëqind e pesë milion e dyzet e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë e shtatëdhjetë e dy lek) pa TVSH, sipas situacioneve përkatëse mujore, ndërsa për periudhën 31 Maj 2018 e në vijim është realizuar vlera 107,687,190 lekë pa TVSH. Bazuar në ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ju sqarojmë se nga ana e Bashkisë Pogradec është trajtuar edhe kërkesa për informacion nr.2850 protokollit datë 24.07.2018 protokolluar pranë institucionit tonë në datë 26.07.2018 me nr 5656 prtokollit hyrës datë 26.07.2018 e Bashkisë Maliq. Kërkesa e mësipërme lidhet mbi angazhimin e shoqërisë tuaj në kontratën e sipërcituar, për të cilën Bashkia Pogradec i ka kthyer përgjigje me anë të shkresës nr. 5656/1 protokollit datë 27.07.2018. Bazuar në nenin 3 pika 3 dhe 14 të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit” bashkëngjitur lutem gjeni kopje të njësuar të korenspodencës me institucionin e Bashkisë Maliq.”

II.7. Referuar informacionit të dorëzuar konstatojmë se vetë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë autoritetit kontraktor ka kryer verifikimet përkatëse në lidhje me vërtetimin e sipërcituar të lëshuar nga Bashkia Pogradec në zbatim të parashikimeve të nenit 66 pika 2 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, e cila sërish ka konfirmuar se kontrata është zbatuar vetëm nga shoqëria “Rej” shpk në zbatim të nenit 74 pika 5 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në rastin konkret, institucioni përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës bazuar në nenin 62 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, Bashkia Pogradec, ka paranuar me anë të më shumë se një akti se kontrata e mësipërme është zbatuar vetëm nga shoqëria “Rej” shpk, për shkaqe të parashikuara nga neni 75 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të



Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, të ndryshuar, shkaqe të cilat referuar kuadrit ligjor në fuqi, konstatohen nga autoriteti kontraktor përgjegjës për zbatimin e kontratës dhe vetëm pas miratimit të po të njëjtit autoritet zbatimi i kontratës mund të vijojë me një nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë.

Gjykojmë se është jashtë kompetencës së saj ligjore, shqyrtimi dhe vlerësimi i shkaqeve të tilla të kosntatuara dhe të pranuar në një moment të mëparshëm, të cilat nuk lidhen me procedurën e prokurimit objekt ankimi, por me një institucion tjetër të qeverisjes vendore, i cili është përgjegjës për zbatimin e kontratës në fjalë. Duke marrë në konsideratë faktin se referuar edhe vërtetimit lëshuar nga Bashkia Pogradec se kontrata e mësipërme është realizuar e plotë vetëm nga operatori ekonomik “Rej” shpk, për shkaqe të përligjura po nga i njëjti autoritet kontraktor dhe të pranuar, deklarimi i përqindjes së bashkëpunimit mes operatorit ekonomik “Rej” shpk dhe “Shpresa” shpk nuk ka tashmë asnjë vlerë në procesin e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave. Sa më sipër, KPP gjykon se në rastin konkret, me anë të dokumentacionit të dorëzuar në Sistmin e Prokurimeve Elektronike, operatori ekonomik ankimues ka dëshmuar se plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit në drejtim të eksperiencës së më parë të ngjashme vetëm me kontratën e lidhur me Bashkinë Pogradec.

### **Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.**

III. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Rej” shpk për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *“Mungon leja mjedisore, kodi III.1.A sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme). a) Leje Mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh.. (Kodi III.1.A) - Leja e paraqitur PN -2521-04-2016 është “Stacion transferimi për mbetje jot e rrezikshme” dhe lejatjetër PN -5796-09-2017 është “Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të amballazheve, paketimeve ose kontinjerëve në mënyrë që të ripërdoren.”* Vërejmë se:

III. 1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

- 1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me leje të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit, (e vlefshme).*
  - a. Leje mjedisore e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) për pastrimin, larje rruges, fshirje rrugesh . (Kodi III.1.A)*

- b. *Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) lidhur me ndikimin në mjedis të leshuar nga QKL. (Kodi III.2.A).*
- c. *Liçense e leshuar nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) grumbullim dhe transportim të mbejtjeve urbane të leshuar nga QKL. (Kodi III.2.B).*

*(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë licencat profesionale pika a, b, c, )*

III.2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Rej” shpik ka dorëzuar:

- Leje Kodi III.I.A e tipit “C” *“Pastrim, larje sprucim ose veshje të mbetjeve të amballazheve, paketim, ose të kontenierëve në mënyrë që të përdoren”* me nr. PN-5796-09-2017
- Leje Kodi III.I.A e tipit “C” *“Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme”* me nr. PN-2521-04-2016

III.3. Në nenin 46, pika 1 gërma “a” dhe “b” ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se: *“[...] 1.Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurorhet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata; b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; [...]”*

Në nenin 28, pika 5, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose [...]”*.

Në seksionin Fusha III, “Kategoria III.1. “Për ndikimin në mjedis” , pika 1 dhe 2 gërma “a” të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të

tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “Lejet mjedisore të përcaktuara në 34 pika 5 e ligjit nr.8934, datë 5.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar bëjnë pjesë në kategorinë III.1 të shtojcës së ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”11[11]. 2. Lejet e ndikimit në mjedis ndahen në tre nënkategori si vijon:

a) “Leje e thjeshte mjedisore” me kodin III.1.A;

b) “leje mjedisore” me kodin III.1.B;

c) “leje e integruar mjedisore” me kodin III.1.C.

3. Emërtimi në pikën 2.a zëvendëson emertime “autorizim mjedisor” dhe “pëlqim mjedisor” që përdoren para fillimit të zbatimit të këtij vendimi sipas pikës 7 më poshtë. 4. Leja e nënkategorive A, B, C, trajtohen sipas grupit III. Dokumentet provuese e shoqëruese që dorëzohen nga kërkuesi, kuptimi i llojit të veprimtarive dhe i ndikimit të tyre në mjedis, institucioni tjetër, procedura e shqyrtimit të kërkesë prej tij dhe afatet për t’iu përgjigjur QKL-së për një kërkesë që ka kaluar fazën e parë nga QKL, për nënkategoritë A, B, C janë ato respektivet e përcaktuara nga ligji nr.8934, datë 5.9.2002 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”, i ndryshuar, dhe aktet nën/ligjore në zbatim të tij.

Në shtojcën e ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” parashikohet se:

*Fusha III*

*Mjedisi dhe burime mjedisore bazë*

*Leje*

Në nenin 29 të ligjit nr. 10 431, datë 9.6.2011 “PËR MBROJTJEN E MJEDISIT”, parashikohet se: *Dhënia e lejeve të mjedisit përcaktohet sipas një sistemi të përbërë prej tri nivelesh, mbështetur në madhësinë dhe llojin e veprimtarisë që ka nevojë të pajiset me leje, si dhe në mundësinë që ka ajo veprimtari të shkaktojë ndotje në atë masë që mund të sjellë dëm në mjedis dhe të rrezikojë shëndetin e njeriut: a) kategoria e veprimtarive A, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit A; b) kategoria e veprimtarive B, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit B; c) kategoria e veprimtarive C, për të cilat zbatohet leja e mjedisit e tipit C. Kategoritë e veprimtarive dhe kufijtë ndërmjet tri niveleve përcaktohen në ligjin për lejet e mjedisit në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se: Leje mjedisi e tipit A” është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKL-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjisllacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime*

Në nenin 4 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit, I ndryshuar” i cili në nenin 3 pika 12 të tij parashikon se:

. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën I/A të këtij ligji;

Në nenin 8 të Ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar parashikohet se:

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e me shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A, B apo C, sipas rastit.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk përgatit lejen e mjedisit të tipit A, kur provon mbi baza objektive se:

a) pas zotërimit të asaj lejeje, kërkuesi nuk do të jetë operator i instalimit në fjalë;

b) kërkuesi nuk do të sigurojë funksionimin e instalimit, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen në lejen përkatëse të mjedisit të tipit A.

Për qëllime të këtij paragrafi, merret në konsideratë edhe historia e deriatëhershme e këtij kërkuesi të lejes dhe/ose historia e deriatëhershme e instalimit.

Në nenin 30 “Kufijtë e Shqyrtimit të Ankesës” të Vendimit nr 596/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përrjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre

III.4. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

III.5. Konstatohet se në interpretim të dispozitave të mësipërme ligjore, si edhe nenit 46 pika 1 dhe nenit 28 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” të ndryshuar në bazë të së cilës vendosen edhe kriteret e veçanta për kualifikim qëllimi i autoritetit kontraktor dhe synimi i kërkesës së autoritetit kontraktor lidhet me vërtetimin se operatorët ekonomikë pjesëmarrës disponojnë licencat e nevojshme për kryerjen e veprimtarisë së kontratës së prokurimit objekt ankimi. Në rastin konkret, gjykojmë se autoriteti kontraktor ka kërkuar disponueshmërinë e licencës së fushës III kategori 1 nënkategoria “A”. Ligji specifik që rregullon licencimin e shoqërive është ligji nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë” i cili në shtojcën e tij parashikon se Fusha III e lejeve përfshin lejeve kategoria i përfshin lejet për aktivitete të cilat kanë ndikim në mjedis. Gjithashtu edhe akti i dalë në zbatim të këtij ligji Vendimi nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënkategorive të përbashkëta”, të ndryshuar në asnjë rast nuk parashikon një leje mjedisore e kategorisë III.1.A në përputhje me objektin e vendosur nga autoriteti kontraktor. Vetë VKM 53/2011 referon se kushtet e veçanta të nënkategorive të lejeve përcaktohen nga ligji nr. 10 431, datë 9.6.2011 PËR MBROJTJEN E MJEDISIT. Ky ligj parashikon detyrimin e paisjes me leje mjedisore të nënkategorisë A, B, C por duke referuar në zbatim të një ligji tjetër, siç është ligji nr.10448 datë 14.07.2011 “*Për lejet e mjedisit, I ndryshuar*”. Referuar Ankesit 1 të ligjit leja e fushës III.1 nënkategoria A jepet për një objekt specifik në fushën e menaxhimit të mbetjeve me përshkrim *per pastrimin, larje rruges, fshirje rruges*. Sa më sipër, KPP gjykon se licencimi në Republikën e Shqipërisë me leje të fushës III.1 nënkategoria A i nënshtrohet kuadrit ligjor sektorial në të cilin nuk parashikohet një leje specifike për këtë fushë me këtë përshkrimi të kërkuar nga ana e autoritetit kontraktor.

Në nenin 30 “Kufijtë e Shqyrtimit të Ankesës” të Vendimit nr. 596/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre.

Gjykojmë se në rastin konkret ndodhemi ka lidhje të drejtpërdrejtë midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre. Gjykojmë se megjithëse në kriteret e veçanta të kualifikimit nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar dorëzimi i Lejes Mjedisore sipas fushës së përshkruar, referuar kuadrit ligjor në fuqi, shoqëritë nuk mund të aplikojnë dhe për rrjedhojë të licencohen për fushën e mësipërme. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e autoritetit kontraktor se *Nga sa me sipër është pergjegjesi i OE te vertetoje disponimin e ketyre lejave mjedisore, Neni 34/4, i ligji Nr, 8934 date 05.09.2002 Per mbrojtjen e mjedisit thekson. Deklarata mjedisore, leja mjedisore, pelqimi*

dhe autorizimi, jane dokumente zvrtae, qe percaktojne kushtet dhe rrethanat ne te cilat do te zhvillohet veprimtaria e miratuar, per parandalimin dhe pakesimin e ndikimeve te saj ne mjedis. KPP konstaton se, arsyetimi i mësipërm është referuar një baze ligjore të shfuqizuar, pasi referuar nenit 73 të ligjit nr.10431 datë 09.06.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit” ligji nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” dhe veçanërisht neni 34/4 është shfuqizuar. Gjithashtu pjesa tjetër e ligjit nr.8934 datë 05.09.2002 “Për mbrojtjen e mjedisit” është shfuqizuar edhe me anë të ligjit nr. 91/2013 “Për vlerësimin strategjik mjedisor”.

#### **Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik qëndron.**

IV. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Rej” shpk për skualifikimin e ofertës së tij me argumentin se: *Ka mangesi ne permbushjen e pikes 3.2 Kapacitetet teknike, pika 5: Operatori ekonomik te kete te punesuar Mjekun e shoqerise, e vertetuar kjo me - Kontratë pune (e vlefshme), - Urdhër Mjeku, - CV, - librezë pune, - diplomën perkatëse .Te jete ne listepagesa per periudhen janar 2017- janar 2018. - Mjekja Ersjona Topalli duke u bazuar ne listëpagesat, për periudhën Gusht 2017- Janar 2018 rezulton me leje lindje.* Vërejmë se:

IV. 1. Në shtojcën 8 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik” autoriteti kontraktor ka parashikuar se:

2. *Bazuar ne Ligjin Nr.10237, date 18/02/2010 “Per sigurine dhe shendetin ne pune”, i ndryshuar, neni 23 si dhe vendimin Nr.312, date 05.05.2010 “Per mirtaimin e rregullores per sigurine ne kantier”, ankesi V, VKM nr.742 date 06.11.2003, duhet qe Operatori ekonomik te kete te punesuar Mjekun e shoqerise , e vertetuar kjo me*

- *Kontratë pune (e vlefshme),*
- *Urdhër Mjeku,*
- *CV,*
- *librezë pune,*
- *diplomën përkatëse.*
- *Te jete ne listepagesa per periudhen janar 2017- janar 2018.*

*(Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë pjesë të stafit 1 (një) mjek të përgjithshëm të punësuar dhe të rezultojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën e kerkuar. Kjo të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave si më lart).*

IV. 2. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, në përmbushje të kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Rej” shpk ka dorëzuar:

- Kontratë pune lidhur me mjeken E. T shoqëruar me CV, librezë pune, Diplomë dhe Licencë dhe listëpagesat për periudhën e kërkuar.

IV.3. Në nenin 46, të LPP-së parashikohet se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Në nenin 53, pika 3 të LPP-së parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.*

Në nenin 26, pika 8, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

IV.3. Pasi, shqyrtuam dokumentacionin e dorëzuar në SPE nga ana e operatorit ekonomik ankimes, mjekja E.T figuron në listëpagesa nga Janari 2017 e në vijim dhe referuar edhe deklarimeve të ankimesit, fakti që kjo e fundit është me *leje lindje* nuk çënon thelbin e vijueshmërisë së marrëdhënieve të punës sa saj me shoqërinë. Akoma më tej, gjykojmë se në dokumentet e procedurës së prokurimit autoriteti kontraktor ka parashikuar se mjekja e shoqërisë duhet të figurojë në listëpagesat e kësaj të fundit dhe marrëdhënia midis saj dhe shoqërisë në lidhje me nr e ditëve të punës varet nga faktorë të tjerë si kontrata e punës, ekzistenca e shkaqeve ligjore ( si raport, leje lindje, leje e zakonshme) etj.

IV.4. **Gjithashtu, vërejmë se :** Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 të Këshillit të Ministrave “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë” parashikohet shprehimisht se:

1. Në zbatim të nenit 7 të ligjit nr.10 237, datë 18.2.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë”, çdo punëdhënës, për të siguruar parandalimin dhe mbrojtjen e punëmarrësve për të gjitha çështjet, që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë: a) ngarkon një ose disa punëmarrës, si persona përgjegjës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion; b) u drejtohet personave ose shërbimeve të specializuara jashtë ndërmarrjes/institucionit, duke vendosur marrëdhënie kontraktuale me ta.

Kapitulli II “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcaktohet se: “1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon: 1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në: 1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit; b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në nënndarjen 1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”; c) industrinë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”. 1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e: a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë; b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve; c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët; ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”; d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike; dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale; e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike; ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve; f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit; g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit; gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike. 1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet: a) e industrisë bërthamore;

b) me furrat koks; c) e përpunimit të naftës; ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë; d) e industrisë petro-kimike dhe karbokimike; dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi.

1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës: a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A; b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu; c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu; ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu.

1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B.

1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës”.

Për punëdhënësit, që përfshihen në grupet A, B dhe C, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi kryhen gjithmonë nga personat e ngarkuar përgjegjës për çështjet e sigurisë e të shëndetit në punë.

3. Vetëm në rastet kur kapacitetet dhe burimet e ndërmarrjes/institucionit janë të pamjaftueshme për ta përmbushur këtë shërbim, ato bashkëpunojnë me persona apo shërbime të jashtme të specializuara për zbatimin e masave mbrojtëse dhe parandaluese.



4. Për punëdhënësit e grupit D, përgjegjësitë dhe detyrat e parashikuara në pikat 10 e 11 të kreut III të këtij vendimi, kryhen gjithmonë nga persona apo shërbime të specializuara jashtë ndërmarrjes, të kontraktuara nga punëdhënësi.

IV.5. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar: 1. “Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”. [...] 3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme: b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili: b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune; b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit”. 4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje: “3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi”.

IV.6 Sa më sipër, nënviozjmë se VKM nr. 742 date 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001 ; Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” thuhet shprehimisht se: **Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi**”. Gjithashtu duke qenë se VKM nr. 742 date 06.11.2003 ka ndryshuar VKM nr. 692, datë 13.13.2001 rrjedhimisht edhe kjo e fundit rezulton të jetë e shfuqizuar duke qenë se akti bazë nuk ka më fuqi ligjore. Akti nënligjor në fuqi që rregullon detyrimin e subjekteve juridikë publikë dhe privatë për të punësuar mjek të shoqërisë, tashmë rregullohet nga Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë.

Akti i mësipërm në fuqi Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të

plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë parashikon detyrimin e subjekteve juridikë për punësimin e mjekut të ndërmarrjes në raste të cilat nuk përfshihen në objektin e procedurës së prokurimit objekt ankimi dhe për një numër punonjësish duke nisur nga 750 e deri në 1000 punonjës sipas kategorisë dhe natyrës së veprimtarisë së shoqërisë, ndërkohë që referuar Shtojcës 7 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” , “Kapaciteti Teknik” numri maksimal i punonjësve i kërkuar është 100 punonjës një numër shumë herë më I vogël se numri minimal i kërkuar nga akti nënligjor në zbatim të ligjit për disponsueshmërinë e mjekut të ndërmarrjes.

IV.7. Gjykojmë se autoriteti kontraktor nuk ka bërë referencën e duhur ligjore në kriterin e vecantë të kualifikimit lidhur me disponueshmërinë e mjekut të ndërmarrjes dhe nuk ka hartuar kriterin në përputhje me ndryshimet më të fundit ligjore që rregullojnë marrëdhëniet përkatëse kontraktuale sa i takon mjekut të punës. Në këtë kuptim gjykojmë se plotësimi ose jo i kriterit për mjekun e ndërmarrjes nga anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes duhet parë në dritën e ndryshimeve të fundit ligjore të cilat autoriteti kontraktor duhet ti kishte pasur parasysh në momentin e hartimit të kriterit të kualifikimit. Ritheksojmë bindjen se kriteret e kualifikimit janë të detyrueshme për tu plotësuar nga të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës por ato në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë parashikimet ligjore dhe akomë me tej të bazohen në dispozita të shfuqizuara. Në nenin 30 “Kufijtë e Shqyrtimit të Ankesës” të Vendimit nr 596/2018 të Komisionit të Prokurimit Publik, “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet se: “Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përfundimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre. Gjykojmë se në rastin konkret ndodhemi ka lidhje të drejtpërdrejta midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre. KPP gjykon se autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit vendosjen e një kriteri referuar një baze ligjore të shfuqizuar.

#### **Sa më sipër pretendimi i palës ankimese qëndron.**

V.. Gjithashtu, referuar trajtimit të ankesë së operatorit ekonomik ankimes me anë të shkresës nr. 3127/1 protokollit datë 15.08.2018, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave ka ngritur pretendime shtesë për skualifikimin e ofrës së operatorit ekonomik ankimes,

IV.1 Në nenin 63 pika 1.1. dhe pika 2 e Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar parashikohet se “Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit tëkontratës në

faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës. Kur ankimesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji. Në kreun X “Shqyrtimi i Ankesave”, neni 78, pika 6 i Vendimit nr.914 të Këshillit të Ministrave datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar parashikohet se “Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave.” Në nenin 78, pika 6 gërma “ç” të Vendimit Nr.914 dt.29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet se: [...] Për shqyrtimin e ankesave, autoriteti kontraktor ndjek hapat e mëposhtëm: a) Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përfundimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës. Anëtarët e komisionit/zyrtari i ngarkuar nuk duhet të kenë marrë pjesë në marrjen e vendimit, për të cilin është paraqitur ankesa. Në rast se ankimi lidhet me dokumentet e tenderit, titullari i autoritetit kontraktor mund t’ia ngarkojë shqyrtimin e ankesës komisionit të vlerësimit të ofertave. b) Njësia e prokurimit mbledh të gjithë informacionin e nevojshëm për të shqyrtuar ankesën dhe për të ndihmuar komisionin/zyrtarin e ngarkuar për shqyrtimin e saj. c) Vendimi në lidhje me ankesën duhet të merret brenda 7 (shtatë) ditëve nga marrja e saj. Nëse kërkohet informacion tjetër nga ankimesi, atëherë afati kohor i sipërpërmendur ndërpritet dhe fillon përsëri pasi autoriteti kontraktor ta sigurojë këtë informacion. ç) Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, komisioni/zyrtari i ngarkuar për shqyrtimin e saj mund të marrë vendim për refuzimin ose pranimin e ankesës, i cili i komunikohet menjëherë titullarit të autoritetit [...].”

V.2 Theksojmë faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për

palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike, (Neni 4 i Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”). Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në neni 2 të tij janë ato të mos diskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementëve të mësipërm lidhet ngushtësisht me elementë të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Në interpretim sistematik (domethënjën e drejtë të normës juridike duke e vënë në lidhmëri me normat e tjera brenda sistemit juridik), gjykojmë se ligjvënësi ka ndarë qartësisht dy momentet proceduriale atë të vlerësimit të ofertave nga ana e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe momentin e dytë të garancisë proceduriale të mbrojtjes së interesave të ligjshëm të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit, atë të ankimit administrative pranë autoritetit kontraktor ( rishikimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave) nga vetë autoriteti kontraktor por nga një trupë e re, e cila nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesave me komisionin e vlerësimit të ofertave, shqyrtimin e ankesave nga K.Sh.A. (Komisioni i Shqyrtimit të Ofertave). Normativa e mësipërme, parashikuar nga neni 63 i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar, rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimimin për të vënë në lëvizje dhe investimin e autoritetit kontraktor për rishikimin e vendimit të KVO-së. Procedura përpara autoritetit kontraktor si edhe para KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (lat.-jurisdiction voluntari) pasi autoriteti kontraktor dhe vetë KPP nuk mund të bëhet vet-iniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i K.Sh.A dhe KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuara dhe vetëm në lidhje me objektin e ankesës. Sa më sipër, gjykojmë se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk mund të ngrëjë pretendime shtesë për skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomi kankimues.

**Sa më sipër arsyetuar, gjykojmë se ankesa duhet pranuar dhe autoriteti kontraktor duhet të rivlerësojë procedurën e prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik “Rej” shpk.**

**Gjykojmë se oferta e shoqërisë “Rej” shpk është gjithashtu edhe oferta me cmimin më të ulët e cila përmbush kriteret për kualifikim.**

**Anëtar**

**Lindita Skeja**

**Anëtar**

**Vilma Zhupaj**